



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 59/2019 regjistër (JR)
Datë 13.11.2019

Nr. 6 i vendimit
Datë 17.03.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 17.03.2022, ditën e enjte, në orën 15:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Hysen Keta, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 189, datë 25.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysen Keta,

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 7, 13, 14 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut; nenet 1, 2, 63 dhe 66, pika 1, germa

“b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi e më pas në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe të avokatit të tij Julian Mërtiri, të paraqitura në ankim, të ngritura përgjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe në konkluzionet përfundimtare, të cilët kërkuan përfundimisht ndryshimin e vendimit nr. 189, datë 25.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Hysen Keta (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet dhe për shkak të funksionit, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe në nenin 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 i dërgoi Komisionit aktin e përfundimtar¹ të kontrollit të deklaratës së pasurisë, duke konkluduar se: i) ka kryer deklarin të pasaktë, në përputhje me ligjin; ii) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii) ka mosdeklarime të pasurive në deklaratat e interesave privatë ndër vite; iv) nuk ka kryer deklarin të rremë; v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 10.05.2018.

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës, i ka përcjellë Komisionit raportin² duke konstatuar përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Hysen Keta.

2.3. KLP-ja, për subjektin e rivlerësimit Hysen Keta, i ka përcjellë Komisionit raportin³ e arsyetuar për aftësitë profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 189, datë 25.07.2019, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Hysen Keta, me funksion prokuror/drejtues pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet”.
4. Këtë vendim Komisioni e ka mbështetur mbi konkluzionet e arritura për secilin nga kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat ka konkluduar, si vijon.

4.1 Lidhur me vlerësimin e pasurisë, *subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimet e pasurive në deklaratën “vetting”, si dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

4.2 Lidhur me kontrollin e figurës, *subjekti i rivlerësimit Hysen Keta arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

4.3 Lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, *trupi gjykues krijoi bindjen se mangësitë profesionale të konstatuara nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas pikës 1/c të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.*

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 189, datë 25.07.2019, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit duke kërkuar ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmim në detyrë, duke pretenduar se ka nivel

² Shkresa nr. {***} prot., datë 30.10.2017, e deklasifikuar me shkresën nr. {***} prot., datë 30.05.2018.

³ Shkresa nr. {***} prot., datë 22.05.2018.

të besueshëm të kriterit të pasurisë dhe se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi ishte marrë në vlerësim të gabuar të provave të paraqitura prej tij përgjatë hetimit administrativ.

6. Shkaqet e ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konsistojnë në mënyrë të përmbledhur:

6.1. Shkaqet ankimore me natyrë procedurale:

i. Komisioni e ka kryer procesin e hetimit administrativ në shkelje të parimit të kontradiktorialitetit, të barazisë së armëve dhe të gjykimit në seancë publike sipas trajtimit të Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së, duke cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, pasi të njëjtët anëtarë të trupit gjykues kanë kryer hetimin, kanë mbledhur provat, kanë ngritur dyshimet dhe kanë dhënë edhe vendimin përfundimtar,

ii. Vendimit i mungon objektiviteti dhe proporcionaliteti, referuar nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi bazohet vetëm në rezultatet e hetimit administrativ, pa u dhënë rëndësi provave të paraqitura prej tij. Komisioni ka shkelur parimet mbi bazën e të cilave vlerësohen provat dhe ka mbivlerësuar e u ka dhënë përparësi konkluzioneve të këshilltarit ekonomik të Komisionit, në kundërshtim me qëndrimet e mbajtura në vendimin nr. 12/2003 të Gjykatës Kushtetuese.

iii. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkon riçeljen e hetimit gjyqësor, marrjen e provave të reja dhe rivlerësimin e provave të administruara nga Komisioni, me qëllim konstatimin e drejtë të gjendjes faktike, bazuar në nenet 49 dhe 51, germa “c” e ligjit nr. 49/2012.

6.2. Shkaqet në ankim që lidhen me vlerësimin e pasurisë, në mënyrë të përmbledhur konsistojnë:

6.2.1. Lidhur me pasurinë *shtëpi banimi trekatëshe, me sipërfaqe 190 m², të ndërtuar në vitet 1996 – 2001*, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

i. Konkluzioni i Komisionit është i gabuar dhe vendimi nuk mbështetet në provat e paraqitura dhe të administruara gjatë hetimit administrativ, duke i dhënë një vlerë të paracaktuar analizës financiare të kryer nga vetë Komisioni, dhe duke refuzuar padrejtësisht kërkesën për të marrë një provë kryesore, sikurse akti i ekspertimit vlerësues të pasurisë që do të ndryshonte rezultatin përfundimtar lidhur me përlllogaritjen e kostos së ndërtimit dhe të vlerësimit për deklarimin e pamjaftueshëm.

ii. Nuk janë mbajtur llogari për koston e ndërtimit të kësaj pasurie pasi ndërtimi është kryer në një kohë kur subjekti nuk ka mbajtur funksione publike dhe nuk kishte detyrim për deklarimin e shpenzimeve. Ky ndërtim është kryer në masën 80% gjatë viteve 1996-1997, periudhë gjatë së cilës nuk ushtronte detyrën e prokurorit dhe nuk do të kishte asnjë kufizim apo interes logjik të deklaronte një shumë më të vogël apo më të madhe se ajo që ka deklaruar për herë të parë në

DPV-në e vitit 2003. Burimi financiar i ndërtimit janë të ardhurat familjare, kryesisht nga puna e subjektit të rivlerësimit si avokat.

iii. Komisioni ka cenuar parimin e barazisë së armëve, duke pranuar vlerat e Entit Kombëtar të Banesave (në vijim “EKB”) dhe duke mos marrë për bazë aktin e ekspertimit e refuzuar kërkesën për ekspert të pavarur të subjektit të rivlerësimit.

iv. Komisioni ka kryer vlerësim të gabuar të rrethanave dhe të provave për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie dhe përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës. Subjekti i rivlerësimit ka qenë i licencuar dhe ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 1994 – 1998. Për këtë periudhë edhe ka paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, sipas një kodi fiskal me të cilin ka qenë i regjistruar pranë organeve tatimore.

v. Provat për të ardhurat nga avokatia, sikurse vendimi i regjistrimit, konfirmimi i pajisjes me licencë dhe vërtetimi i pagesës së detyrimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 1994 – 1998, krijojnë bindjen për ligjshmërinë e tyre në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës.

vi. Përgjigjja nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është interpretuar në mënyrë të pasaktë nga ana e Komisionit pasi i referohet bazës së të dhënave që kjo drejtori disponon aktualisht, sepse nuk disponon të dhëna për periudhën në të cilën subjekti ka ushtruar këtë aktivitet, sipas tij ka qenë e pamundur të kryhej pagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore pa qenë i regjistruar në organet tatimore.

vii. Për të provuar të ardhurat nga avokatia, duhet të merren në konsideratë disa rrethana bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sikurse koha e hershme e krijimit të tyre – përpara 2 dekadave nga miratimi i paketës së reformës në drejtësi – mungesa e detyrimit të kohës për të ruajtur dokumentacionin provues, realiteti i zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në vitet 1997 – 1999, si dhe vështirësia në ruajtjen e dokumentacionit për shkak të afateve të gjata nga koha e krijimit të të ardhurave.

6.2.2. Lidhur me *pasurinë e paluajtshme shtëpi banimi dykatëshe, me sipërfaqe totale 120 m², secili kat me sipërfaqe 60 m²:*

i. në përlllogaritjet e kryera nga Komisioni, duhet të ishin përfshirë të ardhurat nga qiradhënia e shtëpisë;

ii. për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues, raporti i hartuar nga eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme është e vetmja mundësi e të provuarit të kostove reale të ndërtimit, raport i cili nuk u mor në konsideratë nga ana e Komisionit.

6.2.3. Lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament me nr. 59, me sipërfaqe 61,8 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e rrjedhura nga aktiviteti privat i z. P. dhe të ardhurat e tij ishin të mjaftueshme për të mbuluar pagesat e tre kësteve.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. *Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit*

I) *Juridiksioni i Kolegjit dhe legjitimimi i ankuesit*

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës duke qenë subjekt rivlerësimi. Ankimi është regjistruar pranë Komisionit më datë 18.10.2019, ndërsa data e dorëzimit të njoftimit të vendimit të subjektit të rivlerësimit, është 05.10.2019, sipas lajmërimarrjes së shërbimit postar. Për rrjedhojë, ankuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* pasi ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016 brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

II) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

8. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, i nënshtrohet parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, “Gjykimi në apel administrativ në dhomë këshillimi”, i ndryshuar, për shqyrtimin e ankimit në bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit. Rezultoi se një nga kërkesat kryesore të subjektit të rivlerësimit ishte kalimi për shqyrtim i çështjes në seancë gjyqësore publike dhe riçelja e hetimit gjyqësor për të rivlerësuar provat dhe për t’i dhënë mundësi atij të dëgjohet nga gjykata.
9. Kolegji, referuar faktit se ndodhej para shqyrtimit të ankimit të ushtruar prej subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit, në bazë të parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 filloi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi më datë 09.12.2021. Fillimisht, Kolegji vlerësoi të marrë në shqyrtim shkaqet ankimore me natyrë procedurale për të vendosur mbi formën e shqyrtimit të çështjes, në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh apo në seancë gjyqësore publike, nëse do të evidentonte shkelje procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e që do të legjitimonin vendimin e Kolegjit për një

shqyrtim gjyqësor publik. Në vijim, Kolegji çmon të trajtojë fillimisht disa nga shkaqet ankimore me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit.

9.1. Lidhur me pretendimin se Komisioni e ka kryer procesin e hetimit administrativ në shkelje të parimit të kontradiktorialitetit, të barazisë së armëve dhe të gjykimit në seancë publike, meqenëse i ka njoftuar rezultatet e analizës financiare pasi është marrë vendimi për përfundimin e procesit të hetimit administrativ, duke mos vlerësuar si provë aktin e ekspertimit të vlerësimit të paraqitur nga subjekti. Procesi i rregullt ligjor, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit dhe të barazisë së armëve sipas trajtimit të Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNj-së, është cenuar. Komisioni nuk e ka vënë në dijeni për identitetin e personit që ka kryer analizën financiare dhe nivelin e njohurive të tij. Subjekti nuk kishte mundësi të kundërshtonte rezultatet e analizës financiare pasi Komisioni ka pasqyruar si në raport ashtu edhe në vendim, vetëm përfundimin dhe jo provën, gjë që bie ndesh me parashikimet e nenit 20 e vijues të ligjit nr. 49/2012, sikurse referon neni 55, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton:

9.1.a. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen gjyqësore, rezulton se subjektit të rivlerësimit i është dhënë mundësia të paraqesë shpjegime dhe prova, fillimisht në përgjigje të pyetësorëve, më pas në përgjigje të barrës së provës, të përcjellë me rezultatet e hetimit administrativ dhe më tej me shpjegimet dhe sqarimet e dhëna në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision. Në një periudhë prej rreth 16 muaj, prill 2018 (përgjigjet e pyetësorit standard) e deri në korrik 2019 (përgjigjet e rezultateve të hetimit administrativ dhe të dhënat mbi udhëtimet), subjekti ka zhvilluar komunikim intensiv me Komisionin. Në dosje gjenden të administruara përgjigjet e rezultateve të hetimit dhe dokumentet shoqëruese në mbështetje të shpjegimeve dhe sqarimeve të dhëna.

9.1.b. Nga përgjigjet e pyetësorëve⁴ rezulton që Komisioni ka kërkuar sqarime dhe dokumentacion justifikues mbi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave privatë periodikë dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe mbi përgjigjet e pyetësorëve të mëparshëm. Rezultatet e hetimit administrativ dhe analiza financiare bazohen në të dhëna të ekstraktuara nga deklaratimet dhe dokumentacioni i mbledhur. Për rrjedhojë, logjikshëm, analiza financiare nuk mund të hartohet para se të administrohen të gjitha informacionet dhe të dhënat e nevojshme. Në të kundërt, në mungesë të dokumentacionit dhe shpjegimeve nga subjekti, rezultati i saj do të paragjykonte situatën financiare të subjektit.

9.1.c. Nga ana tjetër, citimi i plotë i të gjitha akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit apo të administruara gjatë procesit në vendimin përfundimtar, megjithëse është një praktikë e mirë arsyetimi, mbetet një vlerësim i Komisionit dhe nuk përbën element përcaktues për vlefshmërinë

⁴ Pyetësorët nr. 2, datë 06.05.2019; nr. 3, datë 27.05.2019; nr. 4, datë 05.06.2019.

e vendimit, në referim të nenit 57, pika 4⁵ e ligjit nr. 84/2016. Gjithsesi, rezulton që Komisioni ka cituar në tekst, por edhe në poshtëshënime aktet të cilat është referuar për ekstraktimin e të dhënave me qëllim kryerjen e vlerësimit ligjor.

Analiza financiare e hartuar nga Njësia e Shërbimit Ligjor e Komisionit shërben për të evidentuar situatën financiare të subjektit dhe të personave të lidhur me të, bazuar në të dhënat dhe informacionin e administruar gjatë procesit të rivlerësimit. Me marrjen e analizës financiare paraprake, subjektit të rivlerësimit i mundësohet e drejta e kontradiktorialitetit në proces dhe zbatimi i detyrimeve dhe të drejtave të barrës së provës, nëpërmjet provueshmërisë së të ardhurave, shpenzimeve dhe kursimeve. Analiza financiare është pjesë e detyrave që kryhen nga Njësia e Shërbimit Ligjor sipas nenit 23 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të studimit të dosjes nga pikëpamja financiare/ekonomike për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sa më sipër, nënkupton që analizat paraprake të kryera nga Njësia kanë efekt mbështetës për trupin gjykues, por jo efekt determinues në përfundimin e çështjes.

9.1.ç. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në faqet 3-4 të vendimit, Komisioni sqaron se ka hetuar faktet dhe ka analizuar raportin e dorëzuar nga ILDKPKI-ja, deklaratën e pasurisë dhe deklaratat periodike të pasurisë ndër vite, provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, provat shkresore nga institucionet qendrore shtetërore, bankat e nivelit të dytë, zyrat vendore dhe drejtoritë rajonale, institucionet dhe entet publike, zyrat noteriale, dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit. Komisioni është shprehur në vendim edhe që ka hetuar çdo informacion në drejtim: i) të verifikimit të vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; ii) të verifikimit të burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; iii) të evidentimit të ndonjë fshehjeje të mundshme të pasurive në pronësi apo përdorim; dhe iv) të evidentimit të ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë situatë konflikti interesi, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

9.1.d. Sa më sipër, duke pasur parasysh edhe zbërthimin e parimeve të procesit të rregullt ligjor referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁶ dhe GjEDNj-së⁷, mbi gjykimin kontradiktor dhe barazinë e armëve për rëndësinë e veçantë që merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e arsyeshme që u jepet palëve për të paraqitur deklaratimet, provat dhe vlerësimet ligjore të lidhura me çështjen që shqyrtohet, sikurse e ka trajtuar edhe subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij, trupi gjykues

⁵ “Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi”.

⁶ Shih vendimin nr. 21, datë 16.04.2015; vendimin nr. 34, datë 29.05.2015; vendimin nr. 37, datë 30.06.2016 etj.

⁷ Shih Ruiz-Mateos kundër Spanjës; McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar; Vermeulen kundër Belgjikës; Lobo Machado kundër Portugalisë; Kress kundër Francës etj.

konstaton që pretendimet e subjektit se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt nuk qëndrojnë, pasi janë të pambështetura në provat e administruara.

9.2. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se i është *cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, pasi të njëjtët anëtarë të trupit gjykues kanë kryer hetimin, kanë mbledhur provat, kanë ngritur dyshimet dhe kanë dhënë edhe vendimin përfundimtar, në konflikt të hapur interesi dhe në kundërshtim me parimet e kontradiktorialitetit, gjykimit të drejtë, të paanshëm, të pavarur dhe të pandikuar nga faktorë të tjerë*. Subjekti argumenton se nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj sipas përcaktimeve të nenit 6/1 të KEDNJ-së dhe praktikës së konsoliduar të GjEDNJ-së, dhe se qëndrimi i Komisioni ka qenë i njëanshëm, i pabarabartë dhe diskriminues pasi në raste të ngjashme, Komisioni nuk i ka konsideruar diferencat financiare në vlera të përafërta me të tija si të mjaftueshme (referuar vendimit nr. 169/2019⁸). Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk ka në përbërje të tij gjyqtarë, gjë që bie ndesh me praktikën⁹ e GjEDNJ-së, e cila ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit disiplinor që ka kompetencën për caktimin e masës disiplinore.

9.2.a. Kolegji konstaton se ky pretendim lidhet me funksionimin dhe organizimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit që lidhen me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit individualisht. Sjellim në vëmendje se përputhshmëria e veprimtarisë së institucioneve që kryejnë procesin e rivlerësimit me parimet e nenit 6 të KEDNJ-së në drejtim të garantimit të pavarësisë dhe paanshësisë, është certifikuar në fillim të procesit nga Komisioni i Venecias¹⁰, ka kaluar testin e kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese¹¹ dhe së fundmi edhe çështja e gjykatës së krijuar me ligj është konfirmuar nga shqyrtimi në praktikë nga GjEDNJ-ja në vendimin që i përket Xhoxhaj kundër Shqipërisë¹². Në këtë të fundit, GjEDNJ-ja nuk konstatoi shkelje të nenit 6/1 të KEDNJ-së lidhur me mënyrën e funksionit të Komisionit dhe Kolegjit. Përpos kësaj, në kushtet kur vendimi i Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit të hollësishëm nga ana e Kolegjit, garancitë për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim efektiv dhe të paanshëm adresohen edhe nga Kolegji. Pretendimi për cenim të procesit të rregullt ligjor për shkak se e njëjta trupë gjykimi heton, shqyrton dhe vendos, është i pabazuar. Referuar jurisprudencës së GjEDNJ-së, ndër të tjera në *Morel kundër Francës, Hauschildt kundër Danimarkës* etj., në

⁸ Vendim që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. R. P.- <https://kpk.al/znj-regleta-panajoti-gjyqtare-ne-gjykatene-rrethit-gjyqesor-tirane/>.

⁹ Vilho Eskelinen dhe të tjerë kundër Finlandës 2006, Olujić kundër Kroacisë 2009, Mishgjoni kundër Shqipërisë 2010, Zalli kundër Shqipërisë 2011, Maktouf dhe Damjanović kundër Bosnje dhe Hercegovinës, Micallef kundër Maltës 2009, Volkov kundër Ukrainës 2013, Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës 2019, e vendime të tjera, si dhe në akte të tilla si Karta Evropiane mbi Statusin për Gjyqtarët, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave CM/Rec (2010), si dhe opinionet e Komisionit të Venecias, sikurse Opinioni i Ndërmjetëm §§ 109 - 116 dhe Opinioni Përfundimtar §§ 64 – 68, nr. 824/2015, Raporti mbi Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor, ndër të tjera.

¹⁰ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2016\)036-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2016)036-e).

¹¹ Shih vendimet nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017 - http://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php.

¹² <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%22tabview%22:%22document%22,%22itemid%22:%22001-208053%22>.

kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i paanshëm në momentin e gjykimit në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar¹³.

9.2.b. Trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur mënyra e funksionimit të institucioneve të rivlerësimit u është nënshtruar tashmë filtrave të analizës së kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i mbështetur në ligj dhe, për rrjedhojë, nuk qëndron.

10. Përveç sa më sipër, përgjatë shqyrtimit gjyqësor në dhomë këshillimi, bazuar në përcaktimet e nenit “F”, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 51, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), si dhe neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim konstatimin e drejtë të gjendjes faktike të çështjes, Kolegji me vendim të ndërmjetëm vendosi të përsërisë marrjen e një prove nëpërmjet kërkimit të informacionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, mbi të dhënat që këto institucione disponojnë, lidhur me aktivitetin e subjektit të rivlerësimit si avokat, të ushtruar në periudhën 1994-1998. Nevoja e rimarrjes së kësaj prove u determinua nga fakti se nga përmbajtja e shkresave të përcjella prej organeve tatimore, rezultonte se për subjektin e rivlerësimit nuk rezultonte të kishte të dhëna për pagimin e detyrimeve tatimore, referuar bazës së të dhënave sipas sistemit C@ts dhe regjistrit kombëtar të regjistrimit, akte të cilat, siç do të arsyetohet edhe në vijim, janë krijuar si të tilla pas viteve 2013 dhe nuk mund të ishin baza e të dhënave për informacione që presupozohej të kishin ekzistuar në vitet 1994-1998. Gjithashtu, nga aktet në dosjen e krijuar në Komision, nuk rezultonte që organet tatimore t’i kishin dhënë subjektit të rivlerësimit një përgjigje shteruese për mungesën e të dhënave, megjithëse kjo ishte kërkuar shprehimisht prej tij¹⁴. Për këtë qëllim, Kolegji vendosi të vazhdojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit.
11. Në zbatim të vendimit të Kolegjit, datë 09.12.2021, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë përcolli shkresat nr. {***}, datë 15.12.2021 dhe nr. {***} prot., datë 06.01.2022, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve përcolli shkresën nr. {***} prot., datë 30.12.2021, të cilat pasi iu vunë në dispozicion subjektit të rivlerësimit dhe ai u dëgjua lidhur me to në seancën gjyqësore publike të datës 26.01.2022, u administruan me cilësinë e provës.

¹³ Paragrafët 142 – 163 të Udhëzuesit mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – E drejta për një proces të rregullt (aspekti civil) - https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_6_SOI.pdf.

¹⁴ Shkresa nr. {***}, datë 20.16.2019, “Kërkesë për informacion” drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nga ana e subjektit të rivlerësimit. Kthim përgjigjeje nr. {***}, datë 04.07.2019, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në të cilën citohet se: “[...] në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore për periudhën 1994-1998, për të cilën jeni i regjistruar me vendim gjykate nr. {***}, datë 19.01.1994, me profesionin Avokat, ju informojmë se nga verifikimi i të dhënave të nxjerra nga arshiva rezulton se në emrin tuaj nuk disponohet dokumentacion për sa ju kërkoni”.

12. Nga vëzhguesi ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit u paraqit në Kolegj opinionin nr. {***} prot., datë 01.02.2022, sipas të cilit një hapësirë interpretimi (shumë) e gjerë e pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për të dalë në përfundimin se faktet e kësaj çështjeje justifikojnë zbatimin e dispozitës në fjalë, do të bënte të pamundur në këtë çështje dhe në çështjet e ardhshme dallimin midis rrethanave “të jashtëzakonshme” kur dokumentet nuk disponohen për arsye konkrete, nga çështjet kur dokumentet nuk janë të disponueshme sepse nuk kanë ekzistuar kurrë që në fillim. Vëzhguesi ndërkombëtar konstaton se nuk plotësohen kushtet e parashikuara në pikën 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe, në përputhje me jurisprudencën përkatëse, të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për vitet 1993 – 1998, duhet të konsiderohen si të paprovuara si shumë dhe mund të mos konsiderohen të ligjshme sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Vëzhguesi Ndërkombëtar vëren se ky opinion [obiter dictum] për moszbatimin e pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nuk paragjykon konkluzionin thelbësor përfundimtar për zbatimin ose jo të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
13. Në kushtet kur opinionin e sipërcituar i vëzhguesit ndërkombëtar u paraqit në fazën procedurale në të cilën gjykata ishte tërhequr në dhomë këshillimi për marrjen e vendimit përfundimtar, trupi gjykues bazuar në nenin 315 të Kodit të Procedurës Civile, vendosi të revokojë vendimin e ndërmjetëm për mbylljen e shqyrtimit gjyqësor dhe të vërë në dispozicion të subjektit të rivlerësimit, opinionin e vëzhgueses ndërkombëtare, me qëllim dhënien e mundësisë për mbajtjen e një qëndrimi lidhur me të. Subjekti i rivlerësimit përsëriti qëndrimin e tij ashtu sikurse në parashtrimet e paraqitura në seancën gjyqësore publike se në bazë të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është gjendur dhe gjendet në kushtet e pamundësisë objektive për paraqitjen e dokumentacionit që provonte pagimin prej tij të detyrimeve tatimore në vitet 1994-1998. Kolegji mbajti në konsideratë opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar të përshkruar më sipër në arsyetimin dhe qëndrimin e saj për zgjidhjen e çështjes.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe shkaqet e ankimit të lidhura me të

14. *Për pasurinë, shtëpi banimi trekatëshe, me sipërfaqe 190 m² të ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i gabuar dhe vendimi nuk mbështetet në provat e paraqitura dhe të administruara gjatë hetimit administrativ, duke i dhënë një vlerë të paracaktuar analizës financiare të kryer nga vetë Komisioni, duke refuzuar padrejtësisht kërkesën për të marrë një provë kryesore, sikurse ishte akti i ekspertimit të vlerësimit të pasurisë, gjë që do të ndryshonte rezultatin përfundimtar lidhur me përllogaritjen e kostos së ndërtimit dhe të vlerësimit për deklarimin e pamjaftueshëm.*

14.1. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionet se: i) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me vlerën reale të kostove të ndërtimit; ii) nuk ka pasur aftësi financiare në shumën 3.016.117 lekë (sipas përllogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së)

për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajtshme përgjatë viteve 1996 – 1998, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare; iii) nuk ka provuar me dokumentacion ligjor burimet e ligjshme nga ushtrimi i profesionit të avokatit; iv) ka kryer deklaram të pasaktë të përfitimit të pasurisë truall dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të ndërtimit dhe nuk ka provuar burimin e ligjshëm të saj, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

14.2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, rezulton që subjekti ta ketë deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting këtë pasuri si: *shtëpi banimi 3-kate, me sipërfaqe 190 m², ndërtuar në vitin 1996 – 2001, ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë. Kjo pasuri mban numrin {***} dhe është ndërtuar në truallin prej 550 m² të trashëguar nga babai, i ndarë në 1/3 pjesë takuese, mes subjektit, motrës dhe vëllait të tij. Burimi për krijimin janë të ardhurat familjare ndër vite, si dhe të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1993 - 1998. Ndërtimi sipas këtij deklarimi, ka kushtuar 2.200.000 lekë. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, depozituar më 25.03.2004, si shtëpi banimi, 120 m², në vlerën 2,2 milionë lekë, ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, ndërtuar vetë, me kursime familjare.*

14.3. Komisioni, duke marrë në konsideratë disa të dhëna të deklaruara dhe të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, sipas të cilit ndërtimi është kryer në vitet 1996 – 2001 dhe në vitet 1996 dhe 1997 është ndërtuar 80% e kësaj pasurie, në analizën e kryer për përcaktimin e kostos së ndërtimit, i është referuar vlerës për m² për sipërfaqe ndërtimi të shfrytëzueshme, sipas të dhënave¹⁵ të Entit Kombëtar të Banesave. Sipas analizës së kryer në Komision, vlera e ndërtimit të shtëpisë me 3 kate, rezulton 4.092.790 lekë. Mënyra e përlllogaritjes prej Komisionit për nxjerrjen e vlerës së ndërtimit është kryer duke iu referuar kostos mesatare vjetore për ndërtimet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për vlerën 19.581 leke/m² sipërfaqe banimi (shfrytëzimi).

14.4. Lidhur me provën e kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, aktin e ekspertimit të ekspertit vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe kërkesën për caktimin e një eksperti, me pretendimin se kostoja e ndërtimit të kësaj pasurie nuk është identifikuar drejt nga Komisioni dhe nuk janë marrë parasysh pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve në fashikull, vëren se subjekti, në përgjigje të pyetësorëve¹⁶, ka deklaruar se në kushtet kur këtë ndërtim e ka kryer me grupe punëtorësh dhe jo me firma ndërtimi, në mungesë të faturave, preventivëve dhe situacioneve, ka paraqitur aktin e vlerësimit të ekspertit

¹⁵ Vendimet nr. 13, datë 5.1.1998; nr. 214, datë 28.04.1999 dhe nr. 362, datë 14.07.2000 të Këshillit të Ministrave me të njëjtën emërtesë “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “k””; udhëzimi nr. 5, datë 31.05.2001, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “k””.

¹⁶ Pyetësori nr. 2, datë 6.5.2019.

vlerësues të pasurive të paluajtshme, inxhinier P. H., i cili e llogarit koston e këtij ndërtimi në vlerën 2.206.030 lekë. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni shprehet se: *Aktekspertiza Teknike në lidhje me shpenzimin total të ndërtimit në të cilin është pasqyruar se mënyra e përlllogaritjes përmban një opinion të pabazuar në legjislacion, por të përafërt me tregun informal të ndërtimit. Komisioni në vlerësim të këtij akti, ka vërejtur se të dhënat e përdorura nuk bazohen në referenca ligjore, metodologji apo standarde zyrtare të njohura në rastet e ndërtimeve me kosto të ulët apo quajtur ndryshe minimaliste, të cilat kontraktohen për të pastrehët, për të provuar vërtetësinë e shumës së shpenzuar për ndërtimin e kësaj pasurie trekatëshe. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, më datë 16.07.2019, subjekti i rivlerësimit, mbështetur në nenin 49, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 80, pika 1, paragrafi “b” i Kodit të Procedurave Administrative, ka kërkuar caktimin e një eksperti të pavarur të vlerësimit të pasurive të paluajtshme. Me vendimin e datës 18.07.2019, Komisioni, bazuar në nenin 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, vendosi refuzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për caktimin e një eksperti të pavarur për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, të zgjedhur nga shoqata e vlerësuesve të pasurive të paluajtshme (apo çdo ekspert tjetër i pavarur i fushës), për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, të deklaruara prej tij në deklaratën *vetting*, përkatësisht me nr. 1 dhe 2.*

14.5. Kolegji vlerëson se me të drejtë Komisioni nuk ka marrë në konsideratë aktin e ekspertimit teknik të hartuar nga eksperti i zgjedhur prej subjektit të rivlerësimit dhe në përgjigje të kërkesave dhe fakteve të servitura prej tij, pasi në të nuk evidentohen referenca ligjore, metodologji, standarde apo të dhëna zyrtare të njohura për ndërtimet të cilat ekzistonin edhe në kohën e ndërtimit të kësaj pasurie. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson të drejtë edhe vendimin e Komisionit për refuzimin e kërkesën për caktim të një eksperti të pavarur të licencuar, duke qenë se përcaktimi i vlerës së një objekti të ndërtuar në vitin 1997-1998, në ditët e sotme, do të mbetej gjithsesi subjektiv dhe pa ndonjë referencë ligjore të gjithëpranuar për kostot e vlerave të ndërtimit apo metodologjisë së përdorur për llogaritjen e saj. Në të tilla situata, kur subjekti i rivlerësimit dështon të provojë me dokumentacion ligjor koston e objekteve të ndërtuara në mënyrë informale, sipas jurisprudencës së konsoliduar tashmë të Kolegjit, kostoja do të përlllogaritet duke iu referuar çmimeve të përcaktuara ndër vite prej Entit Kombëtar të Banesave, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, jurisprudenca e Komisionit dhe e Kolegjit është bazuar në të dhënat zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave, për të vlerësuar koston e ndërtimit, duke e konsideruar vlerën e përlllogaritur në këtë mënyrë si kosto që përafrohet me nivelin më të arsyeshëm dhe të besueshëm të koston reale të ndërtimit. Kjo metodologji nuk përcakton detyrimisht faktin se kjo vlerë përfaqëson ekzaktësisht koston reale të ndërtimit, por ajo mbetet një vlerë referuese e cila duhet të vlerësohet në drejtim të efektit që ajo do të ketë në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në këndvështrim dhe analizë të të gjitha rrethanave që rezultojnë nga hetimi administrativ, rast pas rasti.

14.6. Për rastin konkret, me konsideratë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka përdorur koston e EKB-së për sipërfaqe shfrytëzimi dhe jo koston për sipërfaqe ndërtimi, ndërkohë që ka llogaritur sipërfaqen e ndërtimit të banesës që është më e madhe se sipërfaqja e shfrytëzimit, trupi gjykues, në vlerësim të jurisprudencës së Kolegjit, por dhe bazuar në legjislacionin e kohës¹⁷, e vlerëson jo të drejtë përlllogaritjen e koston së ndërtimit të këtij objekti duke iu referuar çmimit njësi/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, sipas së cilës, kostoja totale e ndërtimit ka ardhur si rezultat i shumëzimit të sipërfaqes së ndërtimit me koston për sipërfaqe shfrytëzimi, në kushtet kur sipas referimeve të Komisionit se në vendimin e tij, ashtu dhe në dokumentacionin pronësor për këtë objekt, është përcaktuar vetëm sipërfaqja e ndërtimit prej 196,2 m². Në këto rrethana, Kolegji, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu një rillogaritje të koston mesatare të ndërtimit, referuar tabelave të publikuara në faqen zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave ku çmimet për njësi/m² janë të përcaktuara sipas qyteteve dhe jo siç është referuar nga Komisioni në koston mesatare për ndërtimet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, nga ku rezultoi se kostoja totale e ndërtimit për këtë objekt, ishte në vlerën 3.517.464 lekë.

14.7. Trupi gjykues vlerëson se nuk është i bazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit për zbritjen nga kostoja totale e ndërtimit e vlerës që zë përqindja e TVSH-së në këtë ndërtim, pasi ajo është paguar nga subjekti tregtar pranë të cilit ai i ka blerë materialet për ndërtimin e objektit, referuar nenit 1, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar: *Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) paguhet: a. për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

14.8. Trupi gjykues, për të garantuar një gjykim sa më të drejtë dhe të plotë, duke marrë në konsideratë në mënyrë hipotetike edhe pretendimin e subjektit në ankim për llogaritjen e koston së ndërtimit¹⁸ duke zbritur disa elemente të koston si fitimi i planifikuar dhe fondi rezervë nga kostoja e ndërtimit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare bazuar në manualin e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, miratuar me udhëzimin nr. 2, datë 08.05.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 8,83 % për vitet 1996-2000 dhe në masën 9,27 % për vitin 2001, nga ku rezultoi se kostoja totale e ndërtimit për këtë pasuri do të ishte 3.205.493 lekë.

¹⁷ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 13, datë 05.01.1998, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”.

¹⁸ Vendimi nr. 362, datë 14.07.2000; udhëzimi nr. 5, datë 31.05.2001 (marrë kosto mesatare për sip. ndërtimi në qytetin e Tiranës):
<https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-1996/>; <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-1997/>;
<https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-1998/>; <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-1999/>;
<https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2000/>; <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2001/>.

15. Në ankim, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer vlerësim të gabuar të rrethanave dhe të provave për sa i përket burimit të krijimit të kësaj pasurie dhe përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës. Sipas këtij pretendimi, subjekti ka qenë i licencuar dhe ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 1994 – 1998. Për këtë periudhë ka paguar sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, sipas një kodi fiskal me të cilin ka qenë i regjistruar pranë organeve tatimore. Provat për të ardhurat nga avokatia, sikurse vendimi i regjistrimit, konfirmimi i pajisjes me licencë dhe vërtetimi i pagesës së kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 1994 – 1998, krijojnë bindjen për ligjshmërinë e tyre në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës. Trupi gjykues i Kolegjtit, në analizë të këtij pretendimi, konstaton si vijon.

15.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se burim krijimi për këtë pasuri, kanë shërbyer të ardhurat familjare në vite dhe të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1993-1998.

15.2. Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorëve¹⁹, por edhe në sqarimet e rezultateve të hetimit administrativ²⁰, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar faktin se ka ushtruar profesionin e avokatit për periudhën 1994 – 1998 dhe ka qenë i regjistruar në organet tatimore. Në mbështetje të argumenteve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision: i) vërtetimin nr. {***} prot., datë 19.06.2019, të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku vërtetohet se z. Hysen Keta ka paguar kontributin e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore pranë subjektit “Hysen Keta” me nr. regjistri {***}, rajoni nr. {***}, për periudhën 01.01.1994 - 31.03.1998; ii) vendimin nr. {***} të vitit 1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin si person fizik, me objekt ushtrimin e veprimtarisë në fushën e avokatisë. Në kuadër të hetimit administrativ, në Komision është administruar shkresa nr. {***} prot., datë 20.06.2019, e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, në të cilën citohet: [...] Z. Hysen Keta nuk figuron i regjistruar në regjistrin e avokatëve aktiv apo pasiv në Republikën e Shqipërisë. Vlen të theksojmë se regjistrat e avokatëve përmbajnë të dhëna vetëm për periudhën pas vitit 2000. Nga

¹⁹ “Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1993-1998, ju sqaroj se kam marrë licencën për ushtrimin e profesionit të avokatit në nëntor të vitit 1993. Menjëherë kam filluar procedurat e regjistrimit si person fizik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, konform legjislacionit të kohës. Në fund të vitit 1993 ose fillimin e vitit 1994, me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur regjistrimi im si person fizik, me objekt të veprimtarisë “Avokat”. Kopje të këtij vendimi faktikisht nuk disponoj. Gjatë kësaj kohe kam paguar të gjitha detyrimet që rrjedhin si rrjedhojë e ushtrimit të kësaj veprimtarie, duke përfshirë taksat, tatimet dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Aktualisht kam mundur të siguroj vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nr. {***} prot., dt. 19.06.2019, për pagesën e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 01.01.1994 – 31.03.1998.

²⁰ “Unë kam qenë subjekt tatimpagues me status “Person fizik” dhe ushtrroja veprimtari private fitimprurëse dhe, në vijim të aktivitetit që ushtrroja si avokat për periudhën 1994-1998, i nënshtrohesha tatimit mbi të ardhurat që unë realizoja sipas ligjit nr. 7679, datë 03.03.1993. Deklaratën vjetore të të ardhurave për çdo vit ushtrimor, sipas nenit 7 të ligjit të sipërcituar, ua kam dorëzuar organeve tatimore brenda datës 15 janar për çdo vit që unë kam ushtruar aktivitetin si avokat. Me mbylljen e aktivitetit, kam dorëzuar çdo lloj dokumentacioni në organet tatimore e konkretisht dokumentacionin që përcaktonte kodin fiskal ku unë bëja pagesën e kësteve të tatimit të thjeshtuar”.

të dhëna jozyrtare, bazuar një regjistri që ne disponojmë jo në formën e kërkuar nga ligji, rezulton se personi në fjalë figuron si avokat dhe mban licencën nr. {***} [...], shkresa nr. {***}, datë 10.05.2018, e Qendrës Kombëtare të Biznesit, sipas së cilës, nga verifikimi i kryer mbi bazën e emrit si kriter i vetëm kërkimi, rezulton se: shtetasi Hysen Keta figuron i regjistruar si person fizik me vendimin nr. {***} të vitit 1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të cilin nuk gjendet NUIS (NIPT) [...]. Theksojmë se për subjektet tregtare për të cilët nuk është importuar NUIS (NIPT) nga organet tatimore, nuk është bërë plotësimi i të dhënave apo ndryshime në të dhënat e regjistrimit, të dhënat e kërkuara nuk mund të verifikohen saktësisht. Ky regjistër është krijuar disa kohë më vonë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”²¹.

Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.05.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon Komisionin se: [...] pasi bëri verifikimet në të dhënat që disponon në regjistrin kombëtar [...], shtetasi Hysen Keta figuron i regjistruar si Individ Privat për përgjegjësinë tatimore, tatimi mbi të ardhurat individuale (DIVA) [...]. Me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, në përgjigje të kërkesës nr. {***} prot., datë 26.04.2018, të Komisionit informon këtë të fundit se në lidhje me shtetasin Hysen M. Keta: [...] nga të dhënat që disponojmë në sistemin tatimor C@ts në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, rezulton i regjistruar si Individ Privat për përgjegjësinë tatimore Tatimi mbi të Ardhurat Individuale (DIVA) [...].

Referuar këtyre akteve shpresore të depozituara në fashikullin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se, për të provuar të ardhurat nga avokatia, duhet të merren në konsideratë disa rrethana bazuar në nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sikurse koha e hershme e krijimit të tyre, përpara 2 dekadave nga miratimi i paketës së reformës në drejtësi, mungesa e detyrimit të kohës për të ruajtur dokumentacionin provues, realiteti i zhvillimeve ekonomike dhe shoqërore në vitet 1997 – 1999, si dhe vështirësia në ruajtjen e dokumentacionit për shkak të afateve të gjata nga koha e krijimit të të ardhurave dhe veçanërisht fakti se në përmbajtjen e përgjigjeve të ardhura nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, pasqyrohej fakti se të dhënat e kërkuara për subjektin nuk gjenin pasqyrim në regjistrin C@TS dhe në regjistrin kombëtar, të krijuar pas viteve 2011. Trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe riçeljen e hetimit administrativ për rimarrjen e informacionit nga organet tatimore që hidhte dritë rreth faktit të pretenduar nga subjekti se ai gjendej në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhurat e tij nga ky aktivitet sepse dokumentacioni që provonte këtë fakt nuk mund të merrej prej tyre. Në zbatim të këtij vendimi, Kolegji iu drejtua me kërkesën për informacion²² Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, lidhur me të

²¹ Neni 18: “Regjistri është një bazë të dhënash unike, e ndarë në dosje të veçanta elektronike për secilin subjekt që ka detyrimin e regjistrimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Regjistri mbahet në format elektronik. Të gjitha të dhënat, aplikimet dhe dokumentet shoqëruese, të paraqitura në format shkresor apo në format elektronik, sipas këtij ligji do të regjistrohen nga QKR-ja në format elektronik në dosjen e subjektit në regjistër”.

²² Shkresë nr. {***} prot., datë 13.12.2021, e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

dhënat që këto institucione disponojnë, mbi aktivitetin e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit si avokat në periudhën 1994-1998.

15.3. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 06.01.2022, informon Kolegjin se administrata tatimore është në pamundësi objektive për vënien në dispozicion të të dhënave mbi regjistrimin e subjektit tatimor “Hysen Keta” si person fizik dhe të pagesave për detyrimet tatimore që i përkasin periudhës 1994 – 1998, pasi për shkak të kohës së largët, nuk disponohen të dhëna të plota në arkivin e institucionit për të gjitha subjektet tregtare si persona fizikë, si dhe për shkak të mungesës së një sistemi unik dokumentar apo elektronik për atë periudhë.

15.4. Për pasurinë shtëpi banimi trekatëshe, me sipërfaqe 190 m², ndërtuar në vitet 1996-2001 në truallin me sipërfaqe 550 m² të trashëguar nga babai i subjektit, të ndodhur në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë, me burim të deklaruar të krijimit të saj të ardhurat familjare ndër vite dhe të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit për periudhën 1994-1998, për të cilën Komisioni kishte konkluduar se subjekti gjendej në kushtet e mungesës së burimeve për financimin e saj në vitet 1996-1998, meqenëse nuk provonte sipas dokumentacionit tatimor të ardhurat e ligjshme të krijuara nga avokatia, Kolegji mori në shqyrtim dhe vlerësoi një sërë rrethanash që rezultojnë të provuara lidhur me këtë çështje dhe arriti në një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me këtë pasuri.

15.5. Kolegji, pasi vlerësoi informacionin që rezultonte në shkresën nr. {***}, datë 10.05.2018, të Qendrës Kombëtare të Biznesit, ku shtetasi Hysen Keta figuron i regjistruar si person fizik me vendimin nr. {***} të vitit 1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe vërtetimin nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nr. {***} prot., datë 19.06.2019, në të cilin subjekti rezulton të ketë paguar kontributet e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore për periudhën 1.1.1994 – 31.3.1998, si dhe duke marrë në konsideratë shkresën nr. {***} prot., datë 06.01.2022, të ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, ku pasqyrohej fakti se administrata tatimore është në pamundësi objektive për të vënë në dispozicion të dhëna mbi regjistrimin e subjektit tatimor “Hysen Keta” si person fizik dhe të pagesave për detyrimet tatimore që i përkasin periudhës 1994-1998, për shkak të kohës së largët, si dhe për shkak të mungesës së një sistemi unik dokumentar apo elektronik për atë periudhë, çmoi si jo të bazuar në prova qëndrimin e Komisionit për të mos konsideruar në vlerësimin që i bëhet mundësisë financiare të subjektit për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, të ardhurat që ai ka krijuar nga aktiviteti i avokatisë për periudhën 1994-1998.

15.6. Sipas vlerësimit të Kolegjit, nga aktet e administruara e të përmendura më lart, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar aktivitetin e avokatit në vitet 1994-1998, ndërsa rezulton e paprovuar sasia e të ardhurave të pretenduara prej tij se janë krijuar si të ardhura të ligjshme nga ky aktivitet në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të ardhura të cilat

kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie në kohën e ushtrimit të aktivitetit. Në vlerësimin e kësaj situatë faktike nën dritën e kuadrit ligjor të kohës, shihet e vlefshme të përmenden disa konstatime rreth parashikimeve të ligjit në kohën e zhvillimit të këtij aktiviteti, duke i konsideruar në tërësinë e rrethanave të faktit që lidhen me këtë moment.

15.7. Ushtrimi i veprimtarisë së avokatisë starton në vend pas ndryshimeve të sistemit politik, i cili kishte abroguar çdo dispozitë ligjore që lejonte ushtrimin e kësaj veprimtarie që prej vitit 1960, dhe ka nisur të zhvillohet pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7512, datë 10.8.1991, “Për sanksionimin e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”. Sipas parashikimit të këtij ligji, avokatia presupozohet të zhvillohet në formën e një aktiviteti privat fitimprurës, i cili lejohej të zhvillohej që me miratimin e tij. Sipas nenit 4 të këtij ligji, parashikohet se: *Personat fizikë a juridikë privatë, vendas a të huaj, e ushtrojnë veprimtarinë ekonomike private me mjetet e tyre financiare, me kredi, me aksione e forma të tjera.* Profesionin e avokatisë u rregullua me një ligj të posaçëm vetëm në vitin 2003, me miratimin e ligjit nr. 9109, datë 17.7.2003, në të cilin sipas ndryshimeve të vitit 2012, u shtua në nenin 25 shkronja “ë”, e cila parashikonte regjistrimin e avokatit në organet tatimore, si një kusht për ushtrimin e aktivitetit. Ndërsa vetë legjislacioni tatimor dhe ai i sigurimeve shoqërore deri në mars të vitit 1998, nuk rezultoi të ketë parashikime eksplicite për mënyrën, procedurën apo identifikimin e këtij aktiviteti si një burim të të ardhurave të tatueshme dhe që të përcaktojë detyrimet me karakter tatimor apo të tjera që ngarkohen ndaj individëve që ushtrojnë këtë aktivitet. Vetëm me ndryshimet që pësoi ky ligj në vitin 1998²³, u parashikua rregullimi ligjor se Ministria e Financave është organi që përcakton rregullat për përlogaritjen dhe dokumentimin e shlyerjes së detyrimeve financiare të personave që ushtrojnë veprimtari private në vend, duke tentuar të normonte rregullat bazë të përcaktimit të detyrimeve financiare dhe procedurave të pagimit të tyre. Regjistrimi i subjektit si person fizik që ushtron aktivitetin e avokatisë që prej vitit 1993 dhe pagesa e kontributeve për sigurimin shëndetësor e shoqëror të detyrueshëm sipas parashikimeve të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, bindin Kolegjin, ashtu sikurse edhe Komisionin, se subjekti ka ushtruar këtë aktivitet përgjatë kësaj periudhe duke qenë i regjistruar dhe licencuar për këtë qëllim sipas parashikimeve të ligjit. Bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), për të qenë subjekt i skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror, një person duhet të ketë statusin e personit ekonomikisht aktiv, si rrjedhojë e njëjës prej formave/mënyrave të punësimit, që mund të jenë vetëpunësimi apo punësimi si punëmarrës. Siç rezultoi e provuar nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe gjykimit në Kolegj, subjekti ka ushtruar aktivitetin e “avokatit”, që në kuptim të legjislacionit të sigurimeve

²³ Neni 8 i ligjit nr. 7512/1991, i ndryshuar me ligjin nr. 8333, datë 24.03.1998, parashikoi se: “Ministria e Financave përcakton rregulla për dokumentimin ekonomik-financiar, për mënyrën e llogaritjes së kontributit fiskal dhe afatet e derdhjes së tij, si dhe për kontrollin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme të sektorit privat. Ajo përcakton gjithashtu edhe kriteret e llogaritjes së fitimit për personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari private në Shqipëri”.

shoqërore, e vendoste atë në kushtet për t'u konsideruar person ekonomikisht aktiv në formën e të vetëpunësuarit në qytet.

15.8. Sipas nenit 5, paragrafi 3 i ligjit nr. 7512/1991, i ndryshuar në vitin 1993 parashikohej se: *Një kopje të vendimit përkatës të saj, gjykata ia dërgon brenda 10 ditëve, nga data që vendimi ka marrë formë të prerë, organit financiar të juridiksionit të vet dhe bën regjistrimin e pasurive të paluajtshme të subjekteve.* Ky parashikim ligjor, në fuqi në kohën gjatë së cilës subjekti ka ushtruar aktivitetin e avokatisë, duket se përjashton mundësinë e mosregjistrimit në organet financiare të personave që regjistroheshin me vendim gjyqësor si persona fizikë dhe që ushtronin aktivitet ekonomik, duke qenë se ishte vetë gjykata që kishte detyrimin ligjor për të dërguar vendimin e marrë prej saj për regjistrimin e personit, në organet financiare të juridiksionit të vet, me qëllim regjistrimin e personit në to dhe evidentimin e aktivitetit tregtar. Këto parashikime ligjore potencojnë prezumimin ligjor se subjekti i rivlerësimit i cili ishte njohur dhe regjistruar si person fizik në organet gjyqësore dhe ishte regjistruar gjithashtu si person fizik në organet e sigurimeve shoqërore duke paguar sigurimin shoqëror të detyrueshëm për një të vetëpunësuar, duhej të ishte regjistruar si i tillë edhe në organet tatimore, në mos me vullnetin e tij, për shkak të veprimtarisë gjyqësore të gjykatës që e kishte regjistruar atë si person fizik.

Nga aktet e përcjella prej organeve tatimore²⁴, në asnjë rast nuk është deklaruar mosregjistrimi i subjektit tregtar “Hysen Keta” në organet tatimore apo mosdeklarimi i të ardhurave apo mospagimi i detyrimeve tatimore në periudhën 1994-1998.

15.9. Fakti që organet tatimore nuk japin të dhëna për të ardhurat e deklaruara prej tij për këtë periudhë, për shkaqe të cilat sipas përsëkrimit që ato bëjnë në aktet e përcjella prej tyre, nuk lidhen me subjektin, por me elemente kohore dhe faktike që i përkasin mënyrës së organizimit dhe funksionimit në atë kohë të administratës tatimore, si dhe situata faktike e sipërtrajtuar dhe paqartësitë lidhur me ligjin e zbatueshëm në kohën që është ushtruar aktiviteti i avokatisë nga subjekti, vlerësohet prej Kolegjit si një situatë e cila ndonëse nuk konsiderohet se provon të ardhurat e ligjshme, nuk duhet të rëndojë me përgjegjësi subjektin nën dritën edhe të të gjitha rrethanave të tjera. Për më tepër, në këtë vlerësim Kolegji mban në konsideratë edhe faktin që pasuria rezulton të jetë krijuar dhe ekzistuar para se subjekti i rivlerësimit të ishte emëruar në detyrën e prokurorit dhe me burime që bindshëm duket se vijnë nga një aktivitet i ligjshëm, siç është ushtrimi i profesionit të avokatit, aktivitet i cili ndonëse është pjesë e kontrollit dhe verifikimit prej organeve të rivlerësimit, nuk mund të konsiderohet se është objekt i një rëndësie dominuese në raport me qëllimin e vetë ligjit që normon procesin e rivlerësimit kalimtar të

²⁴ Shkresë nr. {***} prot., datë 15.12.2021, “Kthim përgjigje” e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Shkresë nr. {***} prot., datë 31.12.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shkresë nr. {***} prot., datë 06.01.2022, “Kthim përgjigje” e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Shkresë nr. {***} prot., datë 10.05.2018, e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shkresë nr. {***} prot., datë 15.05.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë

gjyqtareve dhe prokurorëve, në fokus të të cilit është kontrolli i pasurive dhe i sjelljes profesionale dhe etike të subjekteve të rivlerësimit, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

15.10. Situata e përshkruar më lart, vë subjektin dhe organet e rivlerësimit në kushtet e pamundësisë për të kontrolluar vërtetësinë e deklarimeve të tij dhe të burimeve të ligjshme të të ardhurave për krijimin e pasurisë së përshkruar më lart, e cila rezulton të jetë krijuar në vitet 1997-1998. Rezultati negativ i përcaktuar në vendimin e Komisionit lidhur me këtë periudhë, por edhe sipas analizës së bërë në Kolegj, në të dyja versionet e kalkulimit të kostos së ndërtimit të banesës, vjen si pasojë e moskonsiderimit të të ardhurave të krijuara në vitet 1994-1998, nga aktiviteti i avokatisë, në asnjë vlerë, situatë e cila, në bindjen e Kolegjit, për çka u arsyetua më lart, duket se nuk i përgjigjet së vërtetës, duke qenë se duket aspak logjike dhe e arsyeshme, që në të gjithë periudhën, subjekti të mos ketë realizuar asnjë të ardhur prej ushtrimit të pranuar të profesionit të avokatit. Kolegji në vijim do të arsyetojë mbi peshën dhe ndikimin që kjo rrethanë do të duhet të ketë mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke konsideruar të gjitha çështjet për të cilat Komisioni ka konkluduar me vendimmarrjen e tij.

- 16.** Për pasurinë shtesë kati me sipërfaqe 60 m² të një shtëpie të ndodhur në ndodhur në rr. “{***}”, kati i parë i së cilës është ndërtuar në vitin 1960 nga babai i subjektit dhe kati i dytë nga subjekti gjatë viteve 2006-2011, subjekti i rivlerësimit pretendon se në përlllogaritjet e kryera nga Komisioni, duhet të ishin përfshirë të ardhurat nga qiradhënia e shtëpisë dhe, për shkak të mungesës së dokumentacionit justifikues, raporti i hartuar nga eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme është e vetmja mundësi e të provuarit të kostove reale të ndërtimit, raport i cili nuk u mor në konsideratë nga ana e Komisionit. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton si vijon.

16.1. Për këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: i) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me vlerën reale të kostove të ndërtimit; ii) nuk ka pasur aftësi financiare në shumën 266.137 lekë (sipas përlllogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së) për të investuar në ndërtimin e kësaj pasurie të paluajtshme përgjatë viteve 2006-2011, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare; iii) ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me kohën e ndërtimit të kësaj pasurie; iv) ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 9049/2003 pasi nuk ka deklaruar shpenzime mbi 500.000 lekë, të bëra në vitet 2006, 2007 dhe 2008 për ndërtimin e kësaj pasurie. Komisioni për rrjedhojë ka çmuar se subjekti nuk ka deklaruar vlerën reale të ndërtimit, si dhe ka mungesë financiare të të ardhurave për ndërtimin e saj, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, referuar paragrafit 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

16.2. Nga analizimi i deklaratës së pasurisë *vetting*, rezulton që kjo pasuri të jetë deklaruar: shtëpi banimi, 2 kate, me sipërfaqe 120 m². Kati i parë me sipërfaqe 60 m² është ndërtuar në vitin 1996 nga babai, pasuria me numër {***} dhe kati i dytë me sipërfaqe 60 m² (pjesa takuese e subjektit prej 1/3) është ndërtuar prej tij gjatë viteve 2006 – 2011. Kjo pasuri është futur në proces

legalizimi më datë 10.01.2017. Si burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar të ardhurat familjare në vite. Kjo pasuri dhe ajo e trajtuar më sipër janë ndërtuar në të njëjtin truall prej 550 m², të trashëguar nga i ati. Po në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”, subjekti deklaroi të ardhura nga qiradhënia e banesës në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, për vitet 2006 dhe 2007, në vlerën 2.300.625 lekë.

16.3. Lidhur me mungesën e aftësive financiare në shumën 266.137 lekë (sipas përlllogaritjeve të kryera me çmimet e EKB-së) për të investuar në ndërtimin e shtëpisë përgjatë viteve 2006 - 2011, si dhe për përballuar shpenzimet, subjekti pretendon se justifikon në mënyrë bindëse me burime të ligjshme financiare krijimin e kësaj pasurie. Në përlllogaritjet e kryera nga Komisioni, duhet të ishin përfshirë të ardhurat nga qiradhënia e shtëpisë. Për vitin 2006, të ardhurat prej saj kanë qenë 1.380.000 lekë, vërtetuar me nxjerrjen e llogarisë bankare pranë Bankës Amerikane të Shqipërisë (sot Banka Intesa SanPaolo), transferuar nga qiramarrësi “{***}”. Sipas subjektit të rivlerësimit, detyrimin për tatimin e ka pasur qiramarrësi duke qenë person juridik tatimpagues i regjistruar në QKB, referuar nenit 33, germa “ë” e ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të pranuar edhe nga Komisioni kur i ka kërkuar këtij subjekti depozitimin e kontratës së qirasë. Mbajtja në burim e tatimit nga qiramarrësi, përbën prezumim ligjor në kuptim të nenit 49, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në ankim, subjekti ka pasqyruar analizën financiare të kryer për periudhën 2006 – 2011.

16.4. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, datë 06.05.2019, subjekti ka deklaruar se sipërfaqja e shtesës së ndërtuar është 79,3 m² dhe, për rrjedhojë, analiza financiare e kryer nga Komisioni është bërë duke llogaritur si vlerë të kostos atë që i takon sipërfaqes 79,3 m². Lidhur me vlerën totale të ndërtimit, në mungesë të dokumentacionit provues, rezultoi se Komisioni e ka llogaritur duke iu referuar sipërfaqeve të ndërtuara për secilin vit sipas deklarimeve të subjektit, shumëzuar me koston mesatare vjetore të shfrytëzimit, sipas përcaktimeve të EKB-së. Kjo mënyrë përlllogaritjeje e vlerës së ndërtimit nuk përputhet me rastet e ngjashme të trajtuara nga vetë Komisioni, por dhe me jurisprudencën²⁵ e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit, ashtu si në pasurinë e parë të trajtuar më sipër, vlerëson se sipërfaqja e ndërtuar duhet shumëzuar me koston mesatare të ndërtimit dhe jo me koston e shfrytëzimit, bazuar në përcaktimet ndër vite të udhëzimeve të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, me qëllim përcaktimin e saktë dhe të drejtë të vlerës së ndërtimit.

16.5. Për përcaktimin e kostos totale të këtij ndërtimi, Kolegji, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu rillogaritjen duke iu referuar koston mesatare, bazuar në çmimet mesatare të EKB-

²⁵ Vendim nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019; subjekti i rivlerësimit D. Rr..

së²⁶ për sipërfaqe ndërtimi në qytetin e Tiranës, nga ku rezultoi se vlera totale e kësaj pasurie është 2.084.006 lekë.

16.6. Me qëllim shqyrtimin tërësor të pretendimeve të subjektit dhe për të paraqitur një pasqyrë të gjithanshme, si dhe për të garantuar një gjykim sa më të drejtë, Kolegji, duke marrë në konsideratë në mënyrë hipotetike pretendimin e subjektit në ankim, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kreu analizën financiare duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 9,39% për vitin 2006 dhe në masën 8,55% për vitet 2007-2011, sipas strukturës së përcaktuar për llogaritjen e kësaj kostoje, bazuar në manualin e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, miratuar me udhëzimin nr. 2, datë 08.03.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, nga ku rezultoi se kostoja totale e ndërtimit do të ishte 1.900.766 lekë për këtë pasuri.

16.7. Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike shpenzime mbi 500.000 lekë, të bëra në vitet 2006, 2007 dhe 2008 për ndërtimin e kësaj pasurie, trupi gjykues vlerëson se ky qëndrim i Komisionit është i pabazuar pasi subjekti nuk ndodhej në kushtet e detyrimit për deklarim të këtij shpenzimi, së pari sepse, për sa kohë detyrimi për deklarim i shpenzimeve të kryera në masën e caktuar nga ligji ka hyrë në fuqi në vitin 2012, me ligjin nr. 85/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, por edhe sikur të ishte i detyrueshëm ky deklarim, ky konstatim lidhur me pasaktësi të subjektit në deklaratimet periodike vjetore lidhur me shpenzimet, nuk mund të ishte një rrethanë e cila do të kishte prodhuar një deklarim të pasaktë sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se kjo pasaktësi nuk konstatohet në deklaratën e pasurisë *vetting*, por në ato periodike, të cilat nuk janë objekt kontrolli në këtë proces, por shërbejnë si akte provuese sipas përcaktimit të nenit 32, pika 5 e ligjit.

16.8. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka bërë deklarime të pasakta lidhur me kohën e ndërtimit të kësaj pasurie pasi, në vetëdeklarimin e paraqitur pranë ALUIZNI-t më datë 30.05.2017, subjekti ka deklaruar se këtë ndërtim e kishte kryer në vitet 2009 – 2010, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* ka deklaruar se këtë ndërtim e kishte kryer në vitet 2006 – 2011, ndërsa në aktin e ekspertimit dorëzuar nga ai në Komision, pasqyrohet se ky ndërtim është kryer përgjatë viteve 2008-2011. Subjekti ka pretenduar gjatë hetimit administrativ në Komision se në

²⁶ Udhëzimi nr. 5, datë 07.09.2006; udhëzimi nr. 2, datë 04.04.2007; udhëzimi nr. 1, datë 20.08.2008; udhëzimi nr. 3, datë 03.02.2010; udhëzimi nr. 4, datë 23.11.2011. Në të gjitha udhëzimet është marrë kostoja mesatare për sipërfaqe ndërtimi në qytetin e Tiranës:

<https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2006/>; <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2007/>;

<https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2008/>;

https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_1_20.08.pdf;

<https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2010/>; <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2011/>.

momentin e deklarimit, i është kërkuar nga punonjësit e ALUIZNI-t përcaktimi i një periudhe kohore sa më të kufizuar. Komisioni e ka kryer analizën duke u bazuar në periudhat kohore që subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, por duke konstatuar njëkohësisht se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në lidhje me kohën e ndërtimit të kësaj pasurie. Në analizë të këtij qëndrimi të Komisionit, Kolegji vlerëson se konstatimi për deklarim të pasaktë për vitet e ndërtimit të kësaj pasurie, ndërsa vetë Komisioni e pranon kohën e ndërtimit të saj sipas deklarimeve të subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* në funksion të analizës financiare të kryer për verifikimin e burimeve të ligjshme për ndërtimin e saj, duket se nuk i përgjigjet logjikës së përdorur prej vetë Komisionit. Vetë Komisioni duket se ka arritur në përfundimin se vitet e ndërtimit janë ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe jo ato të deklaruara në vetëdeklarimin për efekt të procesit të legalizimit, për pasojë deklarimi i kësaj të dhëne në deklaratën e pasurisë nuk mund të konsiderohet i pasaktë dhe që bie ndesh me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

17. Nga analiza financiare e kryer në Komision për secilin vit të periudhës 2006 – 2011, kur është ndërtuar kjo pasuri, rezulton se për vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare në vlerën 266.137 lekë²⁷. Në analizën financiare të kryer në Komision, nuk janë përfshirë të ardhurat nga qiraja, fakt të cilin subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar nëpërmjet ankimit. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton si vijon.

17.1. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në shumën 1.380.000 lekë nga shtëpia e lëshuar me qira gjatë vitit 2006. Kjo pagesë deklarohet se është bërë nëpërmjet Bankës Amerikane të Shqipërisë, ku gjendja më 31.12.2006, është 460.000 lekë. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia e banesës në rr. “{***}”, nr. {***}, Tiranë, me nr. pasurie {***}, për vitet 2006 dhe 2007, në shumën 2.300.625 lekë.

17.2. Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, ka paraqitur disa mandate bankare të Bankës Intesa SanPaolo ShA, të derdhura nga “{***}”, të cilat përbëjnë pagesa të kryera çdo tre muaj, në vlerën 460.125 lekë, me përshkrimin “pagesë qiraje për 3 muaj”, duke filluar nga muaji maj 2006 dhe përfundojnë në muajin shtator 2007. Nga analizimi i lëvizjes së gjendjes së llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në këtë bankë, rezultuan pagesa nga qiraja në shumën 2.713.725 lekë.

17.3. Kolegji, pavarësisht mungesës së kontratës së qirasë në një formë shkresore, vlerëson se nga analiza e të dhënave që burojnë qoftë nga deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, por edhe nga përshkrimet e mandateve bankare në të cilat përcaktohet se në llogari të bashkëshortes së subjektit, janë kredituar shumat respektive, për llogari të pagesës së qirasë nga shoqëria {***}. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se qëndrimi i Komisionit për të mos

²⁷ Shih tabelën nr. 4, faqe 15-16 të vendimit nr. 189, datë 25.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

konsideruar në analizën financiare të subjektit, të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e qirasë me shoqërinë “{***}” për vitet 2006-2007, të cilat janë të dokumentuara me mandatpagesat bankare të Bankës Amerikane të Shqipërisë (sot Banka Intesa SanPaolo), nëpërmjet transferimit nga qiramarrësi “{***}” në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit të vlerës prej 2.713.725 lekësh, nuk është i bazuar në ligj. Së pari, Kolegji vëren se përfitimi i këtyre të ardhurave nga marrëdhënia e qirasë është një rrethanë e provuar nëpërmjet mandatpagesave bankare, të cilat konfirmojnë plotësisht shumën e cituar më lart si të prejardhur prej kësaj marrëdhënieje.

17.4. Përtej kësaj rrethane, Komisioni nuk i ka konsideruar këto të ardhura si të ligjshme në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, duke qenë se nuk është provuar nga komunikimi me organet tatimore, pagimi i detyrimeve tatimore për këto të ardhura. Kolegji, në analizë të parashikimeve ligjore të nenit 33, pika 1, germa “ë” e ligjit nr. 8438/1998²⁸ “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, i ndryshuar, çmon se, referuar faktit se pala qiramarrëse ka qenë person juridik në kohën e ekzistencës së marrëdhënies dhe përfitimit të këtyre të ardhurave, ajo ka pasur edhe detyrimin për mbajtjen në burim të vlerës së tatimit mbi të ardhurat. Në këto rrethana, për sa kohë që detyrimi i përket një personi tjetër dhe jo subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka dyshime për ekzistencën/përfitimin e këtyre të ardhurave nga një burim i ligjshëm, ngarkimi me përgjegjësi i subjektit sipas ligjit nr. 84/2016, edhe në rast të mosshlyerjes së detyrimeve tatimore nga subjekte të tjera të së drejtës, nuk duket se vjen në harmoi me qëllimin dhe kërkesat e ligjit, i cili konsideron të ardhura të ligjshme ato të deklaruara dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, kur këto detyrime i takojnë subjektit të rivlerësimit, personave të lidhur apo të tjerë të lidhur me të. Kolegji konfirmon qëndrimin e tij mbajtur edhe në çështje të mëparshme²⁹, që për sa kohë që të ardhurat janë deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në ato periodike dhe provohet se ekzistojnë dhe vijnë pikërisht nga burimi i deklaruar si i tillë prej subjektit, në rast se mosprovueshmëria e pagimit të detyrimeve tatimore i përket një subjekti tjetër, dhe se subjekti nuk ka dijeni apo një sjellje bashkëpunuese në këtë drejtim, duhet të kalojnë testin e nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016. Nga rasti konkret, qiramarrësi duket se ka vepruar si entitet më vete me elemente të huaj dhe gjithashtu nuk rezulton asnjë e dhënë që të krijon dyshime që në eventualitetin e mospagimit të detyrimeve tatimore, subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni apo miratim për këtë sjellje.

Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se të ardhurat nga qiraja të transferuara në llogarinë bankare të personit të lidhur nga shoqëria “{***}”, i regjistruar me NIPT {***}, plotësojnë testin për t’u kualifikuar si të ardhura të ligjshme, për pasojë përfshirja e këtyre të ardhurave në analizën

²⁸ Ndryshuar me ligjin nr. 8841/2001, i cili parashikoi detyrimin e mbajtjes në burim nga qiramarrësi (kur është person fizik/juridik) të tatimit për pagesat për qiratë.

²⁹ Vendimi nr. 15/2021, datë 18.06.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit K. S.; vendimin nr. 14, datë 15.06.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. I. B..

financiare të vitit 2006, bën që subjekti të rezultojë me balancë pozitive për këtë vit, ndryshe nga rezultati i arritur nga Komisioni pa përfshirjen e tyre.

18. *Lidhur me pasurinë autoveturë, blerë në vitin 2005, në shumën 20.000 euro, në emër të M. K., subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit për pamundësi financiare në vitet 2005 dhe 2006 është i gabuar. Në vitin 2005 janë përlllogaritur shpenzime për udhëtimet jashtë vendit në vlerën 230.584 lekë, të cilat nuk duhet të përlllogariteshin në ngarkim të subjektit dhe bashkëshortes së tij, pasi janë udhëtime pune të mbuluara nga ana e pritësit, nga ana e organizatorëve apo nga ana e institucionit që përfaqësonte. Subjekti pretendon se është njohur me këtë zë të shpenzimeve nëpërmjet rezultateve të hetimit, më datë 04.07.2019 e, për rrjedhojë, është kërkuar më datë 16.07.2019 vënia në dispozicion e të dhënave të plota në bazë të të cilave ishin kryer përlllogaritjet. Të dhënat u vendosën në dispozicion më datë 17.07.2019 dhe provat u siguruan për aq sa ishte e mundur për shkak të kohës së shkurtër. Ndërsa për vitin 2006, Komisioni duhet të marrë në konsideratë të ardhurat nga qiraja, vlerë e rrjedhur nga burim ligjshëm. Në përmbajtje të ankimit, subjekti ka pasqyruar tabelën e analizës financiare të kryer për vitin 2005.*

18.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, deklaroi autoveturë me targa {***}, blerë në vitin 2005, në shumën 20.000 euro, me burim të ardhurat familjare dhe kredi nga NBG Bank ShA, në shumën 10.000 euro. Për këtë pasuri, Komisioni ka kryer analizën financiare lidhur me mundësinë financiare për blerjen e këtij automjeti. Analizës financiare³⁰ i është nënshtruar periudha nga viti 2005 kur është blerë automjeti deri në vitin 2009 kur është shlyer përfundimisht kredia bankare, që ka shërbyer si burim krijimi. Në konkluzion, për këtë pasuri, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 319.074 lekë në vitet 2005 dhe 2006 për të investuar në blerjen e automjetit, për shlyerjen e kredisë në vitet në vazhdim, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

18.2. Në vlerësim të trupit gjykues, pretendimi i subjektit se nuk kishte kohë mjaftueshëm për mbledhjen e provave për dokumentimin e shpenzimeve të lëvizjeve dhe qëndrimit jashtë vendit nuk qëndron. Në *e-mail*-in e datës 08.04.2018, dërguar Komisionit në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka bashkëlidhur dhe tabelën përmbledhëse të lëvizjeve jashtë vendit për periudhën 2011-2017 (6 faqe). Nga aktet në fashikull, rezulton qartë që subjekti ishte në dijeni që pjesë e analizës do të ishin edhe shpenzimet e udhëtimit jashtë shtetit. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin Ç, pika 5 e Aneksit Kushtetues dhe në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, kishte detyrimin të provonte vlerën e shpenzimeve për udhëtimet jashtë shtetit nëpërmjet paraqitjes së dokumentacionit justifikues, çka do të vërtetonte pretendimet e tij të paraqitura në ankim në tabelën financiare për vitin 2005. Periudha 15-mujore gjatë së cilës ka zgjatur hetimi (prill 2018 deri në korrik 2019), nuk mund të argumentohet si kohë e pamjaftueshme për të paraqitur dokumente apo prova që subjekti i vlerësonte me peshë në llogaritjen e këtyre shpenzimeve. Nga

³⁰ Shih tabelën nr. 5, faqe 23 e vendimit nr. 189, datë 25.07.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

procesverbali i seancës dëgjimore të datës 23.07.2019 në Komision, nuk rezulton që subjekti të ketë ngritur këtë pretendim apo të ketë kërkuar më shumë kohë për gjetjen e dokumenteve shtesë lidhur me këto udhëtime.

18.3. Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 03.07.2019, ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Hysen Keta, për të tria kriteret e rivlerësimit: kriterin e pasurisë, kriterin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes. Me datë 04.07.2019, është njoftuar subjekti mbi rezultatet e hetimit administrativ, ku po në këtë datë, konfirmoi në rrugë elektronike njohjen me rezultatet e hetimit. Në datën 16.7.2019, subjekti i rivlerësimit dërgoi në rrugë elektronike prapësimet e tij, si dhe dokumentet justifikuese. Ndër të tjera, në këtë *e-mail*, subjekti parashtronte se: *nuk dispononte të dhëna të plota në lidhje me udhëtimet e kryera në vitin 2005 mbi bazën e të cilave janë llogaritur shpenzimet TIMS, pasi edhe në dosjen e tij, të marrë me CD, nuk i rezultonin të pasqyruara*. Mbi këtë pretendim të subjektit, Komisioni, me *e-mail*-in e datës 17.7.2019, ia vendosi në dispozicion këto të dhëna. Rezulton se në datën 19.7.2019, subjekti dërgoi dokumentacion justifikues në lidhje me pagesën e shpenzimeve të udhëtimeve brenda/jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për vitin 2005. Konkretisht, subjekti depozitoi dokumentin provues për shpenzimet e udhëtimit për një periudhë 3-ditore për arsye pune, si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme, në Strasburg.

18.4. Pas analizimit të të dhënave nga sistemi TIMS për hyrje-daljet e subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve, në funksion të shkaqeve të ankimit, trupi gjyqës, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu një përlllogaritje të shpenzimeve të udhëtimit, bazuar në metodologjinë e aplikuar nga Kolegji. Nga kjo analizë, rezultoi se shpenzimet TIMS të subjektit janë në vlerën 143.402 lekë për vitin 2005. Në përfundim të kësaj analize, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 56.658 lekë në vitin 2005, për të investuar në blerjen e kësaj pasurie/automjet, për shlyerjen e kredisë në vitet në vazhdim, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare. Kjo diferencë negative prej 56.658 lekësh, çmohet jodomethënëse për t'u klasifikuar sipas nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, që do të çonte në aplikimin e nenit 61, pika 3 e po këtij ligji, për deklaram të pamjaftueshëm. Ndërsa për vitin 2006, duke vlerësuar të ligjshme të ardhurat nga qiraja, si arsyetuar në paragrafin 17.3 të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë pozitive.

18.5. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit lidhur me këto pasuri nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme, të parashikuara nga neni 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016 dhe arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për financimin e tyre është i pabazuar në fakte e në ligj.

19. Gjatë hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se subjekti në deklaratat periodike për vitet 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, *kishte deklaruar “gjendje cash, me burim kursime nga pagat, gjendje të cilat dukeshin sikur deklaroheshin të mbivendosura apo të përsëritura në të njëjtën shumë nga viti në vit, madje duke cituar në vitin pasardhës të njëjtin deklaram të vitit paraardhës”*³¹. Pavarësisht shpjegimeve të subjektit lidhur me *cash*-in e deklaruar, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në lidhje me deklarimin mbi gjendjen *cash*, por pavarësisht këtij fakti, në çdo version të marrjes në konsideratë të gjendjes *cash*, në varësi të deklarameve të subjektit, analiza financiare do të rezultonte pozitive. Sipas subjektit të rivlerësimit, në deklarimet e gjendjes *cash*, deri në vitin 2014 është pasqyruar gjendja totale *cash* që kishte në banesë. Në deklarimin e vitit 2015, subjekti ka pasqyruar vetëm kursimet e atij viti, që ishin shtesat e krijuara nga të ardhurat nga paga për atë vit, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk është rideklaruar gjendja *cash* në deklaratën periodike të interesave privatë të vitit 2016, plotësuar më datë 30.03.2017, duke qenë se ishte pasqyruar në deklaratën *vetting*, të plotësuar 2 muaj përpara plotësimit të deklaratës së interesave privatë për vitin 2016. Subjekti argumenton se deklarimi i interesave privatë për vitin 2016 është plotësuar në datën 31.03.2017, ndërsa deklarimi *vetting* është dorëzuar në datë 30.01.2017 dhe në këtë të fundit është pasqyruar gjendja *cash*, e mbetur deri në datën e plotësimit, përkatësisht shumat 5.000 euro dhe 500.000 lekë. Me dorëzimin e deklaratës që i referohet vitit 2016, është konsideruar i ezauruar deklarimi edhe për periudhën janar 2016 - dhjetor 2016.

Trupi gjykues vlerëson se plotësimi me saktësi i deklaramave të interesave privatë është detyrim i subjekteve deklaramese në zbatim të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, por për sa kohë pasaktësia në deklarime nuk rezulton të jetë shoqëruar/pretenduar për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme të subjektit në justifikimin e krijimit të pasurive apo përballimin e shpenzimeve në vitet përkatëse, nuk mund të shërbejë si një shkak për të kualifikuar subjektin në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm si një situatë që parashikon vendosjen e masës disiplinore.

20. Lidhur me pasurinë e paluajtshme apartament me nr. 59, me sipërfaqe 61,8 m², në bashkëpronësi të personit të lidhur, vajzës së subjektit të rivlerësimit, ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e rrjedhura nga aktiviteti privat i z. A. P., bashkëjetues i personit të lidhur, ishin të mjaftueshme për të mbuluar pagesat e tri kësteve për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie. Të ardhurat për pagesën e këstit të parë prej 25.000 eurosh, sipas subjektit, rrjedhin nga fitimi i siguruar nga aktiviteti i z. A. P. nga importi i hidrokarbureve nga Greqia në Shqipëri në vitet 1993 - 1998, dhe tregtimin e cigareve në vitet 1992 - 1994. Në periudhën kur është kryer pagesa e këstit të parë (data 06.12.2007), vajza e tij S. K. nuk ka pasur asnjë njohje me z. A. P. dhe ky i fundit nuk ka qenë asnjëherë subjekt deklarimi dhe nuk ka pasur detyrim ligjor të posaçëm për të ruajtur dokumente të cilat provonin të ardhura, përtej afatit 10-

³¹ Sipas vendimit nr. 189, datë 25.07.2019, paragrafi 4.2.

vjeçar sipas parashikimeve të ligjit nr. 7661, datë 19.01.1993, “Për kontabilitetin”. Ky parashikim ligjor nuk ka ndryshuar ndër vite prej vitit 1993. Kësti i dytë, në shumën 22.153 euro, i cili është paguar në datën 30.11.2016, është pranuar si i justifikuar me burime të ligjshme nga ana e Komisionit dhe subjekti nuk ka ngritur pretendime në ankim rreth pagesës së këtij kësti, për pasojë ai dhe burimet e ligjshme të përdorura për përballimin e tij, nuk janë objekt kontrolli apo verifikimi nga Kolegji. Ndërsa në lidhje me burimin e ligjshëm për këstin e tretë, përveç kursimeve nga aktiviteti tregtar ndër vite, sipas subjektit, në periudhën prej 03.09.2011 - 31.03.2013, z. P. ka realizuar të ardhura neto në vlerën prej 3.500.000 lekësh, të cilat kanë qenë të mjaftueshme për të paguar këstin e tretë në vlerën prej 1.782 euro. Dokumentet provuese të lëshuara nga ISSh, për periudhën janar 2012 - shkurt 2019, dhe vërtetimi për bazën e vlerësueshme për pagat neto të realizuara për periudhën nga 03.09.2011 deri më 31.12.2016, të nxjerra nga regjistrat e shoqërisë (listëpagesa {***}), provojnë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se z. P. kishte burime të ligjshme për të kryer pagesën e kështit të tretë. Subjekti parashtron se pavarësisht kësaj, të ardhurat e tij si prokuror dhe të familjes së tij për vitin 2016, mbulojnë lehtësisht shpenzimet për pagesën e kështit të tretë. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton si vijon.

20.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur, vajza e subjektit të rivlerësimit, deklaroi: *apartament nr. 59, me sipërfaqe 61,8 m², në rr. “{***}”, blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., në shumën 48.935 euro nga A. P., me të cilin bashkëjetojmë.* Në praktikën e ZVRPP-së Tiranë, administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ZVRPP ka konfirmuar regjistrimin e kësaj pasurie në emrin e vajzës së subjektit të rivlerësimit dhe për këtë ka vënë në dispozicion vërtetimin nga dokumenti hipotekor nr. {***}, datë 29.12.2016, në emër të shtetasit A. P. dhe vajzës së subjektit, znj. S. K.. Komisioni, në lidhje me këtë pasuri, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pagesave të kryera për këstin e parë dhe të tretë të kësaj pasurie.

20.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, trupit gjykues i rezulton se kjo pasuri është përfituar nëpërmjet dy kontratave të sipërmarrjes të lidhura me subjektin sipërmarrës {***} ({***} ShPK), konkretisht, sipas kontratës së datës 06.12.2007, në cilësinë e porositësit, është vetëm bashkëjetuesi i vajzës së subjektit të rivlerësimit, z. A. P., ndërsa sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 06.12.2010, porositës janë z. P. dhe znj. S. K. [vajza e subjektit të rivlerësimit]. Me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2016, pala shitëse {***} ShPK, përfaqësuar nga administratori V. A., u ka shitur blerësve A. P. dhe S. K. apartamentin me nr. {***}, me sipërfaqe 61,8 m², ndodhur në katin e {***} të godinës me {***} kate në rr. “{***}”, në vlerën 48.935 euro, duke referuar si kontratë pararendëse të saj, kontratën e sipërmarrjes së vitit 2007, lidhur midis {***} ShPK dhe z. A. P..

20.3. Subjekti ka deklaruar se ky apartament ndodhet në pallatin që është ndërtuar nga shoqëria {***}({***}. ShPK), ku z. A. P. është zotëruar i 40% të kapitalit të shoqërisë dhe prej datës

16.5.2011 dhe në vijim, ai është njëkohësisht edhe administrator i shoqërisë (e cila ka qenë investitore dhe zbatuese) në ndërtimin e këtij objekti. Pagesat për këtë pasuri, sipas akteve të dosjes, janë kryer si më poshtë³².

20.3.1. *Kësti i parë* i kësaj pasurie është paguar në datën 6.12.2007, në shumën 25.000 euro. Kjo shumë është derdhur *cash* nga motra e z. P. për llogari të kompanisë {***} ShPK, me përshkrimin “Pag. kësti”.

20.3.2. *Kësti i dytë*, në shumën 22.153 euro, është paguar në datën 30.11.2016. Asambleja e Ortakëve të shoqërisë {***}. ShPK, ka vendosur që pagat e pamarra nga administratori A. P., për periudhën prill 2013 – tetor 2016, në shumën prej 3.009.756 lekësh, të shërbejnë në kompensim për pagesën e kështit të dytë për apartamentin me sip. 61,8 m².

20.3.3. *Kësti i tretë*, në shumën 1.782 euro, paguar në datën 2.12.2016, sipas mandatarkëtimit të dorëzuar në Komision.

20.4. Kolegji, në analizë të rrethanave të faktit lidhur me këtë pasuri, arriti në një konkluzion të ndryshëm nga Komisioni. Rezulton se pagesa e kështit të parë për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie, të jetë paguar nga motra e bashkëjetuesit të personit të lidhur, znj. E. P., sipas mandatpagesës së bankës BKT, të datës 06.12.2007, në llogari të shoqërisë {***} ShPK, me përshkrimin “Pag. kësti” në vlerën 25.000 euro, përtej kësaj rrethane, Komisioni ka hetuar rreth burimeve të ligjshme të z. A. P. për pagesën e këtij kësti në vitin 2007, duke analizuar të dhënat financiare të aktivitetit privat të kryer nga ky shtetas, duke arritur në konkluzionin se pavarësisht veprimtarisë së tij tregtare, nuk provohet sipas standardit kushtetues dhe ligjor që i takon procesit të rivlerësimit, se z. P. kishte të ardhura të ligjshme për të provuar justifikimin e kësaj pagese në vitin 2007. Ndodhur në këto kushte, për shumën e paguar nga motra e bashkëjetuesit të personit të lidhur, në vlerën prej 25.000 eurosh, si pagesë e kështit të parë, Komisioni i ka atribuuar si detyrim për të provuar burimin e ligjshëm të kësaj pagese subjektit të rivlerësimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, Kolegji vlerësoi se përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit në kuadër të këtij procesi, për mungesën e burimeve të ligjshme për pagesën e kështit të parë të kësaj pasurie, kryer nga bashkëjetuesi i vajzës së subjektit në vitin 2007, kohë në cilën ky shtetas nuk e gëzonte këtë status dhe personi i lidhur kishte ende një moshë minore, është në tejkallim të detyrimeve ligjore që subjekti i rivlerësimit ka për shkak të dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe parashikimeve ligjore në këtë proces. Neni 30 i ligjit nr. 84/2016 ka përcaktuar se detyrimin për justifikimin e pasurive e kanë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të dhe, në kuptim të kësaj dispozite, pagesa e kështit të parë të pasurisë e financuar nga bashkëjetuesi i personit të

³² Vërtetim i lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare për pagesën e kështit 25.000 euro; vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë “{***}” ShPK, datë 30.11.2016; mandatarkëtimi për pagesën e kështit të fundit, nr. {***}, datë 2.12.2016.

lidhur në një kohë që nuk e kishte këtë status, konsiderohet se është fituar prej tij, e del jashtë kategorisë së personave për të cilët subjekti duhet të përgjigjet në këtë proces.

20.5. Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të pagesës së këstit të tretë të kësaj pasurie, kryer më datë 02.12.2016, nga bashkëjetuesi i personit të lidhur (vajzës) së subjektit të rivlerësimit, kohë në të cilën ky shtetas e gëzonte këtë status, Kolegji, në ndryshim nga konstatimi i Komisionit, bazuar në dokumentacionin që vërteton të ardhurat e bashkëjetuesit të personit të lidhur, pas kryerjes së analizës financiare, konstatoi se ky i fundit ka pasur të ardhura të ligjshme për kryerjen saj. Në këto kushte, Kolegji çmon se konkluzioni i Komisionit se subjekti nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të bashkëjetuesit të personit të lidhur për pagesën e këstit të parë dhe të tretë të kësaj pasurie, është i pambështetur në prova e në ligj.

20.6. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Kolegji mori në shqyrtim edhe pretendimin se *vendimit të Komisionit i mungon objektiviteti dhe proporcionaliteti, referuar nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, pasi bazohet vetëm në rezultatet e hetimit administrativ, pa u dhënë rëndësi provave të paraqitura prej tij.*

Kolegji, në përfundim, vlerësoi konkluzionet e arritura në lidhje me pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në një optikë të përgjithshme, sipas standardit kushtetues të parashikuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të *“shpjegimit bindshëm”* të pasurisë, duke zbatuar parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit në kuptim të parashikimit të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili obligon organet e rivlerësimit që në mënyrë diskrecionale, por të arsyetuar e shpjeguar, të shqyrtojnë procesin e rivlerësimit të një subjekti duke konsideruar zbatimin e këtyre parimeve të së drejtës administrative të aplikueshme. Kolegji sjell në vëmendje se në rastin konkret, lind arsyeshem nevoja për konsiderimin e kësaj çështjeje nën dritën e këtyre parimeve, për shkak të faktit se, referuar konkluzioneve të mësipërme për secilin konkluzion të Komisionit, subjekti i rivlerësimit duket se ka dështuar të provojë në mënyrë të plotë të ardhurat e tij nga ushtrimi i profesionit të avokatit në vitet 1994-1998, të cilat kanë shërbyer për financimin e pasurisë së parë, ndërsa në vlerësimin e Kolegjit, subjekti ka arritur të provojë bindshëm burimet e krijimit të pasurive të tjera dhe të personit të lidhur si më sipër trajtuar.

Në kuptim të parimit të objektivitetit, i cili parashikohet nga neni 14 i Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *“Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe u japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative”*, Kolegji vlerësoi konstatimin e mësipërm krahas rrethanave të tjera që e shoqërojnë atë, të cilat në mënyrë thelbësore lidhen me faktin se subjekti provon që ka ushtruar profesionin e avokatit në vitet 1994-1998, sipas regjistrimit të tij si person fizik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pagimit të kontributeve të sigurimit të detyrueshëm shoqëror e shëndetësor si person fizik, elemente që tregojnë se ai e ka ushtruar këtë aktivitet në mënyrë të ligjshme pranë sistemit gjyqësor, i cili në mënyrë primare verifikon dhe

kontrollon ligjshmërinë e ushtrimit të këtij aktiviteti dhe gjithashtu duke e deklaruar atë në organet përgjegjëse që garantojnë mbledhjen e të paktën një prej detyrimeve që i vijnë atij për shkak të legjislacionit në fuqi. Të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet janë përdorur si burim për financimin e një pasurie që provohet se është krijuar gjatë kësaj periudhe, duke përjashtuar dyshimet se deklarimi i tyre mund të ketë lidhje me qëllimin për mbulime me burime të ligjshme të pasurive të krijuara më pas, gjatë kohës kur subjekti ushtronte detyrën e prokurorit.

20.7. Krahas arsyetimit të mësipërm, Kolegji pati në konsideratë në mënyrë integrale e në harmoni me njëra-tjetrën disa rrethana, si: i) informacionin e përcjellë prej organeve tatimore të cilat referojnë në mungesën e të dhënave lidhur me aktivitetin e subjektit për shkak të kohës së largët dhe mungesës së një databaze unike; ii) faktin që subjekti i rivlerësimit e ka ndërprerë aktivitetin e avokatit në mënyrë përfundimtare në vitin 1998 dhe ka shkëputur çdo marrëdhënie të mëpasshme me këto organe në këtë cilësi; iii) shumën e konstatuar si mungesë burimesh financiare për periudhën 1996-1997 në vlerën (-) 2.631.493 lekë në versionin se kostoja e ndërtimit do të konsiderohet në vlerën prej 3.517.464 lekësh, ose (-) 2.401.766 lekë në versionin që kostoja e ndërtimit do të konsiderohet se është 3.205.493 lekë, e cila vjen edhe për shkak të një analize financiare mbi të dhëna të pranuar, por jo të dokumentuara në drejtim të provueshmërisë së kostove të ndërtimit; iv) raportin në të cilin qëndron kjo shumë krahasuar me të ardhurat e pretenduara, faktin që në përcaktimin e kësaj balance negative janë konsideruar zero të ardhurat nga avokatia, element që nuk përfaqëson të vërtetën e arsyeshme sipas vlerësimit të Kolegjit, si edhe faktin se ajo i përket një pasurie që rezulton se është krijuar gjatë kohës që subjekti ushtronte profesionin e avokatit.

21. Kolegji vlerësoi rrethanat e analizuara më sipër në harmoni dhe raport me të gjitha çështjet e tjera të cilat u trajtuan në kuadër të kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit në dritën e parimit të proporcionalitetit, parashikuar në nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit: *Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitime, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. 2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës; b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj; dhe c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.*
22. Në kuptim të parashikimit të mësipërm, Kolegji vlerëson se mungesa e provimit të të ardhurave prej ushtrimit të profesionit të avokatit në vitet 1994-1998, nën dritën e rrethanave të analizuara me objektivitet si më lart, edhe pse subjekti nuk konsiderohet nga vlerësimi i trupit gjykues se gjendet në kushtet e nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për shkak se nuk rezulton të provohen në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat e kësaj dispozite dhe se përcaktimi i pamundësisë objektive nuk është një konkluzion që vjen si përcaktim i organeve tatimore, por si një vlerësim

në bazë të rrethanave të faktit dhe ligjit të organeve të rivlerësimit. Pavarësisht sa më sipër, Kolegji mban në konsideratë faktin se, megjithëse provat e disponueshme nga institucionet shtetërore nuk konfirmojnë legjitimitetin e të ardhurave të pretenduara prej subjektit, duke qenë se në organet tatimore kompetente nuk disponohen të dhëna që konfirmojnë pagimin e tatimit, duke qenë se provat sugjerojnë se subjekti ka qenë një avokat aktiv dhe gjasat janë që ai e ka kryer aktivitetin në përputhje me kuadrin ligjor të kohës dhe në mungesë të ndonjë treguesi që të bën të dyshosh se subjekti i vlerësimit, me deklarimin e të ardhurave të tilla, ka synuar të mashtrtojë organet e rivlerësimit ose ka deklaruar qëllimisht ndryshe në mënyrë të rreme, vlerëson se kjo situatë faktike nuk çmohet se është e drejtë të konsiderohet si një mangësi apo defekt i cili të prodhojë për subjektin e rivlerësimit si pasojë vendosjen e masës së shkarkimit të tij nga detyra. Kjo mangësi mbetet e vetmja e konstatuar lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, e vendosur në kontekstin e mësipërm, nuk vlerësohet se ajo mund të prodhojë në mënyrë proporcionale vendosjen e masës së shkarkimit nga detyra, si një masë e nevojshme për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

23. Për sa më sipër, Kolegji çmoi se mungesa e burimeve të ligjshme që rezulton nga analiza financiare e kryer në Kolegji, duke mos përfshirë në të të ardhurat nga avokatia, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
24. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor dhe analizës së mësipërme, Kolegji arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit arriti të shpjegojë bindshëm pasuritë e krijuara prej tij duke kaluar testin e nivelit të besueshëm, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë aplikimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 nuk gjen zbatim.
25. Në kushtet kur subjekti ka rritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “b” dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, Kolegji arrin në konkluzionin se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, i cili ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit nga detyra, mbështetur në kriterin e pasurisë të vlerësuar jo në mënyrë objektive dhe proporcionale, nuk është i drejtë e, për pasojë, ai duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 189, datë 25.07.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Hysen Keta dhe konfirmimin e tij në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 17.03.2022.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha Mulaj

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi - kundër

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Rezarta Schuetz dhe Natasha Mulaj, nuk ishim dakord me zgjidhjen e çështjes që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Hysen Keta kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) dhe votuam kundër shumicës, e cila konfirmoi subjektin në detyrë. Në vlerësimin tonë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe, për pasojë, vendimi i Komisionit për shkarkimin e tij duhet të ishte lënë në fuqi. Argumentet mbi të cilat bazohet vlerësimi ynë, shtjellohen në vijim, sipas radhës së parashtrimit të tyre në ankim.

I. Mungesë burimesh për krijimin e pasurisë shtëpi banimi në vitet 1996-2001

2. Komisioni konstatoi se subjekti ishte në kushtet: (i) e deklarimit të pamjaftueshëm në lidhje me koston reale të ndërtimit; (ii) e mungesës së burimeve në vlerën prej 3 milionë lekësh [afërsisht] për periudhën 1996-1998, për shkak të mungesës së burimeve të ligjshme të mjaftueshme nga ushtrimi i profesionit të avokatit nga subjekti, pretenduar si burim krijimi i kësaj pasurie; si dhe (iii) të deklarimit të pasaktë të mënyrës së përfitimit të një pjese të truallit mbi të cilin ndodhet kjo pasuri.
3. Subjekti i rivlerësimit në ankim kërkoi që kostot e ndërtimit të përlllogariten sipas vlerës së sugjeruar nga eksperti i tij dhe jo sipas kostove mesatare të ndërtimit të përlllogaritura nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”). Subjekti po ashtu kërkoi që, në funksion të analizës së burimeve të ligjshme, të përlllogariten të disponuara të ardhurat për shpenzimet e jetesës dhe nga avokatia si prej tij, meqenëse ishte në pamundësi objektive për të provuar këto të fundit sepse – sipas tij – mungonin përgjigjet nga institucionet. Për këtë qëllim, subjekti kërkoi përlllogaritje të ardhurash “mesatare” nga avokatia. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i ka atribuar vlerë provuese vendimtare pagesës së sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore prej tij për periudhën e viteve 1994-1998. Së fundmi, subjekti pretendoi se konkluzioni i Komisionit për pasaktësi në mënyrën e fitimit të truallit, është i pavërtetë. Në këtë funksion, subjekti potencoi vendimin e vitit 1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që përcakton fitimin e një trualli prej 4000 m² në favor, ndër të tjerë, edhe të subjektit të rivlerësimit.
4. Shumica pranoi pretendimet *deklarative* të subjektit se në vitet 1994-1998 ka përfituar 4 milionë lekë – mesatarisht 1 milion lekë në vit – pavarësisht se 7 (shtatë) akte zyrtare të gjeneruara nga administrata tatimore ndër vite, duke nisur nga viti 2017 e deri në dhjetor 2021, pasqyronin qartë që për këtë individ – subjektin e rivlerësimit Hysen Keta – mungojnë të dhënat, ose me fjalë të tjera, mungon regjistrimi dhe shlyerja e detyrimeve. Këto akte sqarojnë që të ardhurat e subjektit nuk provohen, në asnjë shifër vjetore apo në total, e për më tepër, të ardhurat prej 4 milionë lekësh në katër vite, janë kryekëput deklarative. Me vlerë të kufizuar argumentimi, por gjithsesi me rëndësi, është të sjellim në vëmendje që paga e subjektit si prokuror, sapo u rikthye në sistemin e

prokurorisë në vitin 1998, ishte **357.553** lekë, ndërsa teksa ishte avokat, në vitet 1994 - 1998, pretendohet të ishte 1 (një) milion lekë në vit. Kjo diferencë e konsiderueshme mes përfitimeve financiare si avokat përkundër atyre si prokuror, e bën pretendimin e tij për fitime prej 1 milion lekësh, përpos deklarativ, edhe të pabesueshëm pasi bien ndesh me logjikën ekonomike mbi të cilën ai vendosi të rikthehej në radhët e prokurorisë pas katër vitesh financiarisht shumë të suksesshme në sektorin privat, në kushtet kur fitonte tri herë më shumë sesa si prokuror.

5. Edhe aktet zyrtare të mbërritura me kërkesë të Kolegjit, treguan se pretendimi i subjektit se “mungonin” përgjigjet nga autoritetet për të provuar të ardhurat e pretenduara, ishte i pasinqertë. Nga përgjigjja kthyer Kolegjit më datë 15.12.2021, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë [nr. prot. {***}], rezultoi që subjektit i kishte shkuar një përgjigje nga ai institucion në datën 04.07.2019 [me numër prot. {***}]. Në përgjigje, qartazi pasqyrohet se në arkiv nuk ka dokumentacion për z. Keta. Çmojmë të theksojmë se në ankimin në Kolegj, subjekti përcolli vetëm kërkesën e tij dhe pretendoi se përgjigjja nuk ekzistonte.
6. Shumica e gjeti bindës pretendimin e subjektit për mungesë përgjigjeje dhe përfundimisht pranoi si bindëse edhe një përgjigje të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (në vijim “DRT”) të datës 06.01.2022, e cila binte ndesh katërçipërisht me përgjigjen e të njëjtit institucion, drejtuar Kolegjit më 15 dhjetor 2021 – disa javë më herët, nënshkruar nga i njëjti drejtues – por edhe me përgjigje të mëparshme [shih paragrafin 8]. Si përmbledhje, më datë 6 janar 2022, DRT-ja pretendon mungesë dokumentacioni të ruajtur nga kjo administratë për “shkaqe objektive,” duke rënë ndesh me çfarë ka dokumentuar vetë ky institucion, për të njëjtin subjekt, nënshkruar nga i njëjti drejtues i institucionit vetëm 22 ditë më herët – në përgjigjen dërguar Kolegjit më 13 dhjetor 2022, sikurse bie ndesh edhe me 6 (gjashtë) akte të tjera³³ të cilat qartazi tregojnë që z. Keta (i) nuk rezultoi regjistruar, (ii) nuk rezultoi të ketë deklaruar dhe të ketë paguar tatime dhe (iii) nuk rezultoi të ketë numër fiskal identifikimi me anën e të cilit [sipas shkresës orientuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (në vijim “DPT”)] do të duhet të gjurmoheshin të dhënat për të në sistem, ose minimalisht, të konfirmohej regjistrimi në këtë administratë.
7. Votuar kundër shumicës pasi qartazi, në zbatim të ligjit dhe logjikës së ftohtë të fakteve, përgjigjja e datës 6 janar nuk kapërcen testin e vendosur nga neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 që kërkon që vendimet të bazohen mbi prova që bien në *pajtueshmëri të dukshme* me njëra-

³³ Aktet me të cilat përgjigjja e dytë e DRT-së, me nr. prot. {***}, datë 06.01.2022, bie ndesh, janë: (i) përgjigjja e DRT-së drejtuar KPA-së, datë 15.12.2021 [nr. prot. {***}]; (ii) përgjigjja dërguar subjektit Hysen Keta nga DRT-ja më datë 04.07.2019 [nr. prot. {***}]; (iii) përgjigjja e dërguar Komisionit më 15.05.2018 [nr. prot. {***}]; (iv) përgjigjja e dërguar Komisionit më datë 08.05.2018 [nr. prot. {***}]; (v) përgjigjja e dërguar ILDKPKI-së më datë 02.08.2017 [nr. prot. {***}]; (vi) përgjigjja e dërguar ILKDPKI-së më datë 28.07.2017 [nr. prot. {***}]; dhe së fundmi (vii) shkresa dërguar DRT-së nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve [për dijeni edhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit] më datë 30.12.2021 [me nr. prot. {***} dhe {***}], e cila qartazi kushtëzonte ekzistencën e regjistrimit me numrin fiskal dhe detyrimin e subjektit për ta përcjellë atë numër.

tjetrën³⁴. Shtatë (7) shkresat që provonin se subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga avokatia apo paguar detyrime tatimore, u injoruan nga shumica, në favor të një përgjigjeje që binte ndesh me atë pararendëse nga i njëjti institucion dhe me 6 (gjashtë) të tjera nga institucione të ndryshme të administratës tatimore në vite të ndryshme, nënshkruar nga titullarë të ndryshëm, dërguar ILDKPKI-së, Komisionit dhe vetë KPA-së.

8. Theksojmë se përpara/deri më 6 janar 2022, Administrata Tatimore e të dyja niveleve, në harkun kohor prej *korrikut 2017* deri në *dhjetor 2021*, e përfaqësuar nga titullarë të ndryshëm, në asnjë prej përgjigjeve zyrtare institucioneve shtetërore dhe vetë subjektit të rivlerësimit, nuk ka qenë kontradiktore, përkundrazi. Në secilën prej tyre, përkatësisht, aktet zyrtare referojnë që:
 - (i) çdo tatimpagues është pajisur me certifikatë regjistrimi dhe kod fiskal të cilin individi kërkues duhet ta paraqesë në funksion të nxjerrjes së të dhënave;
 - (ii) “në sistemin C@TS dhe në **arshivën** e Drejtorisë Rajonale Tatimore nuk disponohet dokumentacion” dhe që “z. Keta ka marrë përgjigje për këtë fakt më datë 04.07.2019, me shkresën me nr. prot. {***}”;
 - (iii) të dhënat nga arshiva tregojnë se nuk ka dokumentacion për sa kërkohet [nga subjekti, shkresa cituar në pikën “ii” më sipër];
 - (iv) në emër të z. Keta figurojnë regjistrime në C@TS vetëm për DIVA nga viti 2011;
 - (v) nga **regjistri kombëtar**, z. Keta nuk figuron i regjistruar në organet tatimore “për ndonjë aktivitet privat”;
 - (vi) z. Keta nuk rezulton të ketë qenë i regjistruar pranë DRT-së deri në datën 30.01.2017;
 - (vii) z. Keta nuk është i regjistruar si tatimpagues në DRT Tiranë.
9. Çfarë është më e rëndësishmja, në asnjë prej përgjigjeve zyrtare – për këtë subjekt rivlerësimi apo të tjerë të rivlerësuar deri më sot nga Kolegji – asnjë organ i Administratës Tatimore nuk rezulton t’i jetë referuar “pamundësisë *objektive*” për shkak të “kohës së largët” apo të pamundësisë së konfirmimit për shkak të mënyrës së ruajtjes së të dhënave ndër vite. Përkundrazi, të gjitha përgjigjet në mënyrë konsistente, kanë konstatuar mungesën e të dhënave për këtë subjekt apo të tjerë dhe mungesën e regjistrimit të subjektit tatimor. Shkresat mbi të cilat duhet të ishte bazuar vendimi [detajuar në poshtëshënimin nr. 1] qartazi konfirmojnë që subjekti Hysen Keta nuk figuron i regjistruar apo si pagues detyrimesh tatimore, me përjashtim të detyrimeve të paguara në favor të tij nga punësimi si prokuror (si dhe për shkak të vetëdeklarimeve në DIVA pas vitit 2011).

³⁴ “[4.] Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]”.

10. Përgjigjja e dytë, dërguar Kolegjit nga DRT më 6 janar 2022, papritmas, përtej afatit 15-ditor të përcaktuar me ligj, dhe në mënyrë të pashpjegueshme, zhbën përgjigjen e mëparshme nga ky institucion, dhe për herë të parë në historinë e korrespondencës zyrtare nga Administrata Tatimore, referon një situatë faktike të panjohur, të paraportuar, të paprecedentë në procesin e rivlerësimit deri më tani, por me pasoja vendimtare në favor të subjektit të rivlerësimit Hysen Keta.
11. Përpos sa më sipër, ekzistenca e "pamundësisë objektive" për shkak të kohës, referuar për herë të parë më 6 janar 2022, nuk shpjegon cilat janë shkaqet e kësaj pamundësie, nëse ato vlejné për këtë subjekt vetëm apo pasqyrojnë problem madhor të Administratës Tatimore që ndikon edhe mbi subjekte rivlerësimi të vlerësuar tashmë, mbi çfarë rrethanash mbështetet pamundësia objektive – forcë madhore, gabim njerëzor, veprimtari me natyrë penale që ka sjellë si pasojë zhdukjen e akteve. Shkresa në fjalë po ashtu nuk arsyeton përse nuk kanë gjetur zbatim apo referuar më parë nga Administrata Tatimore dhe çfarë ka ndryshuar në harkun kohor nga data 15 dhjetor 2021, kur u referua për mungesë të dhënash [lexo: mungesë regjistrimi], deri më 6 janar 2022, që e ka detyruar DRT-në Tiranë të ndryshonte katërçipërisht përgjigjen e saj të mëparshme, sikurse edhe konstatimet ndër vite për këtë subjekt apo për të tjerë. Theksojmë që përgjigjet zyrtare, dërguar ILDKPKI-së, Komisionit apo edhe Kolegjit, si nga DRT-ja Tiranë, ashtu edhe DPT-ja, kanë përcjellë qartë mungesën e dokumentacionit për këtë subjekt rivlerësimi.
12. Logjikisht, sa është prodhuar nga administrata tatimore deri në shkresën e datës 6 janar bën kuptim pasi nëse do të ekzistonin kushtet e pamundësisë objektive, ato do të duhet të ishin konstatuar dhe ekzistonin për çdo subjekt tjetër. Pamundësi objektive *vetëm* për një subjekt rivlerësimi nuk mund të ketë. Pamundësia objektive e gjetjes së dokumentacionit, logjikisht duhet të jetë pasojë e mosekzistencës së dokumentacionit, apo si rrjedhojë e forcës madhore. Nuk rezulton që Administrata Tatimore të ketë referuar dëmtime për shkak të forcës madhore.
13. Votuar kundër shumicës pasi kjo e fundit e bazoi vendimin e saj në këtë shkresë minimalisht problematike dhe haptazi në kundërshtim me mungesë tërësore harmonie me aktet zyrtare të administruara deri më sot. Ky vlerësim bazohet edhe në faktin që pranimi i përgjigjes së datës 6 janar 2022 nga shumica si bazë vendimmarrjeje, nënkupton që vetëm për subjektin Hysen Keta gjen zbatim pamundësia objektive për të gjetur fashikullin, dhe vetëm në vitin 2022 nga DRT Tiranë. Natyrshëm, mungesa e arsytimit nga DRT-ja krijon një hendek të konsiderueshëm dhe të pashpjeguar për çfarë domethënë në fakt kjo mungesë, përse mungojnë të dhënat, në çfarë rrethanash bazohen rrethanat e pamundësisë objektive vetëm për një individ dhe së fundmi, por po aq me rëndësi, përse referohet pamundësi objektive për herë të parë në 6 janar 2022. Në kushtet kur DRT-ja nuk ka përmendur në asnjë rast deri më 6 janar 2022, pamundësinë objektive, vlerësimi i trupit gjykues duhet të argumentonte çfarë qëndron në themel të kësaj përgjigjeje. Kjo pasi, nëse pamundësia objektive ekziston dhe nuk është referuar më parë, përgjigjet e DRT-së në lidhje me subjekte rivlerësimi të cilët kanë ushtruar profesionin e avokatit në vitet '90, për të cilët

është konkluduar të jenë në kushtet e mosprovueshmërisë së të ardhurave apo ligjshmërisë së tyre, kanë qenë të papërgjegjshme, joserioze dhe me pasoja të rënda për fatin profesional të disa magistratëve. Të tilla përgjigje kanë qenë, ndër të tjera, ato të administruara dhe mbi të cilat është konstatuar mungesë burimesh të ligjshme në çështjet e rivlerësimit që lidhen me subjektet e rivlerësimit Fatos Lulo, Gani Dizdari, Alma Brati³⁵.

14. Theksojmë se kjo përgjigje e dytë që kundërshton të parën në adresë të Kolegjit, nuk sqaron as edhe arsyen përse u dërgua një përgjigje e dytë e cila nuk i referohet së parës, ashtu si nuk i referohet në asnjë pjesë të përmbajtjes së saj orientimi nga DPT-ja që kërkimi dhe përgjigja të ezaurohej nëpërmjet numrit fiskal. Mospërcjellja e këtyre detajeve me rëndësi vendimtare për subjektin, në funksion të provimit qoftë edhe rrethanor të faktit të regjistrimit, konfirmoi sa është konstatuar në mënyrë konsistente në aktet e sipërpërmendura: subjekti nuk është regjistruar në Administratën Tatimore dhe, për pasojë, të ardhurat e tij nuk mund të provohen, përlllogariten apo të plotësojnë kriterin e ligjshmërisë për efekt të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
15. Për të gjitha këto arsye, votuam që ky shkak ankimi i subjektit të rivlerësimit ishte i pabazuar në ligj dhe fakte dhe, për pasojë, konkluzioni i Komisionit ishte i bazuar dhe duhej të lihej në fuqi. Në analizën e kryer mbi aktet në fashikull, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme për të krijuar *këtë pasuri*, në vlerën prej **2.631.493 lekësh**, duke passjellë si rrjedhojë gjendjen e parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Shumica vendosi të bazojë vendimin e saj për këtë aspekt me pasoja vendimtare në procesin e rivlerësimit të subjektit Hysen Keta mbi një përgjigje haptazi kontradiktore me 7 (shtatë) përgjigje të mëparshme, sikurse edhe me gjithë historikun e informacionit zyrtar të përcjellë në ILDKPKI-ja në Komision dhe në Kolegj, që *për herë të parë* në procesin e rivlerësimit evokon pamundësi objektive të pidentifikuara apo mbështetura në prova e akte. Subjekti ka qenë i pasaktë edhe për mënyrën e fitimit të pasurisë truall, një pjesë e së cilës rezulton nga aktet ta ketë blerë nga institucionet shtetërore – fakte që bien ndesh me pretendimin e tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, për pasuri e cila ishte tërësisht e trashëguar.

II. Mungesë burimesh për krijimin e pasurisë shtëpi banimi/shtesë, në vitet 2006-2011

16. Në konkluzionin e tij, Komisioni ka konstatuar që subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për sa i përket *vlerës reale të investimit, kohës së ndërtimit dhe pasaktësive në deklaratat periodike e mungesë burimesh të ligjshme* në vlerën **266.137** lekë në vitet 2005-2006. Shumica vlerësoi që të pranojë shtrirjen kohore të zgjedhur nga subjekti në hetimin administrativ. Duke

³⁵ Shih veçanërisht paragrafët 24, 25 dhe 26 të vendimit të Kolegjit: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-F.-Lulo-pdf.pdf>, paragrafin 37.1.4 lidhur me paragrafin 8/viii të vendimit të Kolegjit: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/VENDIMI-I-ANONIMIZUAR-G.-DIZDARI.pdf>, dhe paragrafët 13.1, 13.2, 23.16 dhe poshtëshënimet nr. 73-75 ku citohen shkresat nga Administrata Tatimore me të dhëna negative për vitet '90, si dhe paragrafi 26.1 dhe poshtëshënimi nr. 92.

pranuar të mirëqena të ardhurat nga qiradhënia e një pasurie të paluajtshme në vitet 2006-2007, balanca negative sipas shtrirjes kohore të investimeve në katër vjet, rezulton pozitive.

17. Votuar kundër shumicës edhe për këtë aspekt të shkaqeve të ankimit dhe procesit të rivlerësimit të subjektit, për disa arsye. Së pari, parë në harmoni me mungesën e burimeve të konstatuara përtej çdo dyshimi për pasurinë e parë, shtjelluar më sipër, balanca negative e burimeve të ligjshme në dispozicion të subjektit për të krijuar këtë pasuri, rezulton me mungesë burimesh të ligjshme *minimalisht* në vlerën **186.395**. Kjo balancë negative përftohet edhe nëse përlllogaritja bazohet mbi shpërndarjen kohore të shpenzimeve sipas pretendimit të subjektit – në pesë vitet nga 2006-2011 – sikurse ka vendosur në mënyrë kontradiktore me arsyetimin e tij dhe me logjikën edhe Komisioni. Themi kështu pasi nëse analiza financiare merr në konsideratë aktet zyrtare në fashikull, diferenca negative thellohet nga **707.910** lekë deri në **1.105.201** lekë. Vlera e parë negative përftohet nëse analiza financiare kryhet bazuar në harkun kohor nga viti 2008-2009, të pretenduar nga subjekti gjatë procesit të legalizimit tek ALUIZNI. Vlera e dytë është pasojë e analizës financiare për investimet e kryera sipas ekspertizës së përcjellë nga subjekti në procesin e hetimit administrativ në Komision, në vitet 2008-2010, për tre vjet.
18. Në vlerësimin tonë, përlllogaritja financiare duhet të mbështetet në periudhën kohore të deklaruar me vullnet të lirë nga subjekti tek ALUIZNI, në kushtet kur subjekti nuk ka deklaruar ndërtimin e shtesës në asnjë moment gjatë deklaramëve periodike vjetore në ILDKPKI. Është domethënës, paçka se nuk u shoqërua me pasoja në procesin e rivlerësimit të kryer në Komision, e për pasojë as në Kolegj, edhe fakti që harku kohor i deklaruar prej subjektit si kohë e ndërtimit të shtesës pa leje pranë ALUIZNI-t, është deklaruar të ketë ndodhur në një moment kohor kur ndërtimi pa leje ishte cilësuar vepër penale³⁶, si pasojë e ndryshimeve të sjella nga ligji nr. 10023/2008. Për këto arsye, duhet të deduktohet që subjekti duhet të ketë deklaruar me përgjegjësi të plotë këtë hark kohor gjatë të cilit është kryer ndërtimi, në kushtet kur për shkak të detyrës së prokurorit të karrierës, duhet të ketë qenë i ndërgjegjshëm për përgjegjësinë penale që kishte për këtë deklaram. Për sa më sipër, vlerësuam që analiza për krijimin e kësaj pasurie në kohë duhet të ishte bazuar në periudhën kohore dyvjeçare, 2008-2009, dhe jo sipas shpërndarjes deklarative të pranuar nga Komisioni sipas pretendimeve të subjektit në pesë (5) vite, konkretisht 2006-2011. Në këto kushte, vlerësuam që subjekti gjendet në situatën e parashikuar prej nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 pasi nga analiza financiare e shpenzimeve kundrejt të ardhurave, ai rezulton me balancën negative prej afërsisht 707 mijë lekësh [shtjelluar edhe më sipër].

³⁶ Neni 199/a i Kodit Penal duke filluar nga viti 2008, nëpërmjet ligjit nr. 10023/2008, datë 27.11.2008, ka parashikuar: “Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

19. Komisioni ka qenë kontradiktor në vendimin e tij, duke krijuar alogjizëm në vendimmarrje që për pasojë, ka krijuar probleme në kontrollin e vendimit të tij nga Kolegji mbi këtë shkak ankimi. Themi kështu pasi, ndërsa masa disiplinore e marrë për subjektin bazohet edhe në deklarin e pasaktë të kohës kur është kryer ky investim dhe vlerën e shpenzuar, në konkluzion Komisioni gjithsesi ka kryer një analizë vetëm mbi shtrirjen kohore të deklaruar nga subjekti në funksion të përmirësimit të situatës, duke ulur në mënyrë të ndjeshme shpenzimet vjetore. Kjo shtrirje kohore bie ndesh me deklarin e vetë subjektit me përgjegjësi përpara një institucioni tjetër shtetëror, si ALUIZNI [shtjelluar në paragrafët 17 dhe 18], apo pretendimet e tij në aktin e ekspertizës financiare të bazuar në të dhënat e ofruara prej tij. Është me rëndësi të theksohet kjo mënyrë kontradiktore e të arsyetuarit pasi në kushtet e ankimeve vetëm nga subjektet e rivlerësimit, gabimet në arsyetim që shkojnë në favor të subjekteve të rivlerësimit, nuk përbëjnë fushë kontrolli nga Kolegji dhe, si të tilla, cungojnë vlerësimin tërësor të pasurisë, e pamundësojnë vlerësimin e drejtë/objektiv të situatës faktike dhe ligjore për Kolegjin, si dhe krijojnë ngërçe procedurale vendimmarrjeje.
20. Në kushtet kur masa e shkarkimit për subjektin është bazuar, ndër të tjera, në konstatimin e deklarimeve të tij kontradiktore, kryerja e analizës sipas shtrirjes kohore të pretenduar prej subjektit, kapërcen kufijtë e lapsusit të thjeshtë nga ana e Komisionit. Ndërsa nga njëra anë Komisioni ka konstatuar deklarin të pasaktë për kohën kur është kryer investimi, në vendim mungon arsyetimi dhe analiza financiare shoqëruese që përkon me shtrirjen kohore që, sipas Komisionit, ishte më e besueshmja. Në të kundërt, në kushtet kur gjithsesi Komisioni nuk ka zgjedhur një periudhë kohore gjatë së cilës duhet të jenë kryer investimet, është e pashpjeguar përse vendimi përmban pasojë në procesin e rivlerësimit për deklarin të pasaktë. Me fjalë të tjera, bilanci negativ do të duhet të shoqërohet me pasojën disiplinore respektive, ose pasoja disiplinore të bazohet mbi bilancin negativ. Asnjë nga këta dy paralelizma nuk ka ndodhur.
21. Votuar kundër shumicës për këtë shkak ankimi pasi në vlerësimin tërësor të rrethanave, përpos mungesës së burimeve për kryerjen e investimit, subjekti rezulton të ketë qenë në kushtet e disa pasaktësive dhe plotësive në deklarin. Konkretisht, themi kështu meqenëse sipërfaqja e shtesës ka rezultuar të jetë thuajse 20 m² më e madhe nga ajo e deklaruar në deklaratën e pasurisë [79,3 m² kundrejt 60 m² të deklaruar]. Komisioni nuk rezulton të jetë shprehur as për këtë deklarin të cilit i ka munguar thuajse ¼ e sipërfaqes. Ndërkohë, Komisioni duket se ka konstatuar se subjekti ka shkelur detyrimet e tij sipas ligjit nr. 9049/2003, meqenëse nuk ka deklaruar shpenzimet mbi 500 mijë lekë në vitet 2006-2011, ndërkohë që ky detyrim është parashikuar në ligj vetëm me ndryshimet³⁷ që ka sjellë ligji nr. 85/2012, datë 18.09.2012. Për sa më sipër, Komisioni ka dalë në një konkluzion të pabazuar në ligj edhe për këtë aspekt. Në përmbledhje dhe pa përsëritur sa më sipër, edhe për pasurinë shtesë, subjekti i rivlerësimit rezulton me balancë negative, qoftë nëse

³⁷ Neni 4, shkronja "h" e ligjit, për pasojë, përcakton se përbën detyrim për deklarin "[h] çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 500.000 (pesëqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit [...]".

përlllogaritja kryhet në versionin kohor të referuar nga deklaratimet e tij zyrtare dhe me përgjegjësi tek ALUIZNI, ashtu si edhe në *dy versionet e ndryshme* kohore të pretenduara prej tij gjatë procesit të rivlerësimit.

22. Nga ana tjetër, subjekti pretendon të ardhura të konsiderueshme nga qiraja, por nuk depozitoi asnjë akt shkresor që të jepte qoftë edhe indirekt detaje për qiranë e paguar dhe detyrimet kontraktore të marra përsipër nga palët. Shumica e pranoi këtë kërkim të subjektit bazuar vetëm mbi transaksionet bankare që provojnë pagesat. Ndonëse jemi dakord që ky fakt përbën një provë, në kushtet kur subjekti nuk provoi në asnjë formë që qiramarrësit ishin persona juridikë dhe jo individë, subjekti dështoi të përmbushte detyrimin ligjor për të provuar ligjshmërinë e burimeve të këtyre të ardhurave.

III. Probleme të tjera të kontrollit të kriterit të pasurisë

23. Komisioni ka hetuar ndër të tjera edhe për një pasuri të paluajtshme³⁸ në pronësi të vajzës së subjektit të rivlerësimit, e cila deri në tetor 2016 ka qenë në certifikatën familjare së bashku me subjektin e rivlerësimit. Pasuria është blerë prej saj me kontratën e shitjes së datës 20.12.2016. Në përfundim, për këtë pasuri Komisioni ka gjetur se nuk u provuan burimet e ligjshme për pagesën e kështit të parë prej 25 mijë eurosh dhe të kështit të fundit, në vlerën 1.782 euro. Duke lënë mënjane konkluzionin e Komisionit për këtë pasuri, në funksion të rivlerësimit të subjektit, mënyra sesi janë vlerësuar faktet është e pabazuar në një analizë të saktë e logjike të akteve në fashikull. Konkretisht, Komisioni ka zgjedhur ta kryejë analizën financiare për burimet e ligjshme në krijimin e kësaj pasurie, bazuar në një kontratë sipërmarrjeje të vitit 2007, dalë në sipërfaqe për herë të parë gjatë procesit administrativ në Komision, megjithëse aktet të cilat kanë passjellë fitimin e pronësisë nga personi i lidhur me subjektin datojnë nga viti 2010, dhe vetë subjekti fillimisht ka pretenduar si burim krijimi kontratën e sipërmarrjes së vitit 2010. Kontrata e vitit 2007, sjellë nga subjekti gjatë procesit administrativ, lehtësonte pozitën e subjektit pasi duke qenë e hershme, nënkupton vite përpara se bashkëjetuesi i personit të lidhur, z. A. P., të kishte fituar atë cilësi.
24. Për pasojë, ndonëse ishim dakord me konkluzionin e Komisionit se bashkëjetuesi i personit të lidhur, z. A. P., nuk provoi burime të ligjshme të mjaftueshme për të financuar këtë pasuri³⁹ tërësisht siç ka deklaruar subjekti, vlerësojmë që analiza e Komisionit bazuar në një kontratë sipërmarrjeje të hershme në kohë, ishte e pabazuar dhe e pasaktë. Në këtë vlerësim, kemi parasysh

³⁸ Apartament me sipërfaqe 61,8 m², në rr. “{***}”, me vlerë 48.935 euro.

³⁹ Nga hetimi administrativ, ka rezultuar që bizneset në të cilat z. P. ka qenë ortak i vetëm apo bashkëpronar janë 5 [shih f. 36-37 të relacionit financiar]. Sipas DRT Tiranë, z. Peza rezulton i regjistruar vetëm nga viti 2005 e më pas për tri subjekte tatimore, ndër të cilat: (i) {***}{***} e cila ndër vite ka pasur fitim, por nuk ka shpërndarë dividend; (ii) {***}, 2014-2016, ka deklaruar humbje çdo vit që nga regjistrimi; dhe Pronatyra, deklaruar vetëm humbje gjatë jetëgjatësisë, 2008-2016, me përjashtim të vitit 2009 kur është deklaruar fitim prej 374.338 lekësh, por jo dividend.

disa elemente. Së pari, vetë subjekti fillimisht ka pretenduar se kjo pasuri ka për zanafillë kontratën e sipërmarrjes së datës **6.12.2010**. Së dyti, analiza e kryer nga Komisioni që zhvendos pagesën e parë në vitin 2007 – bazuar vetëm në një mandatpagesë të një familjareje të z. P. në favor të shoqërisë së ndërtimit të z. P. në vitin 2007 – për një pasuri e cila nuk provon të lidhet me të njëjtin apartament, në mungesë të shpjegimeve bindëse për këtë mënyrë veprimi, është jo vetëm alogjike, por edhe e sforcuar dhe krijon bindjen që është kryer për të favorizuar subjektin.

25. Konkretisht, subjekti pretendoi që në fakt kësti parë ishte paguar në vitin 2007, vit kur personi i lidhur [znj. S. K.] ishte e mitur, ndërsa bashkëjetuesi i saj nuk kishte marrë ende atë cilësi. Pyetur për të shpjeguar kontratën e dytë të sipërmarrjes për të njëjtën pasuri, atë të dhjetorit 2010, deklaruar si burim nga vetë subjekti në hetimin administrativ, në të cilën është palë edhe vajza e subjektit, ky i fundit pretendoi se data në kontratë ishte gabim material, flitej për 6 dhjetor 2016 dhe jo 6 dhjetor 2010. Me fjalë të tjera, subjekti e kundërshtoi plotësisht kontratën e sipërmarrjes të deklaruar fillimisht si burim krijimi të pasurisë dhe, për pasojë, sipas tij, harku kohor nga sipërmarrja e deri te shitja e apartamentit, ishte dy javë – nga data 6 deri më 20 dhjetor 2016 – ndonëse kontrata parashikonte *20 muaj afat për ndërtuesin* në nenin 8 të saj. Mbeti e pashpjeguar nga subjekti se si përputhet kjo kontratë sipërmarrjeje e vitit 2016 – sipas subjektit – me atë të vitit 2007, që sipas tij dëshmonte pagesën e këstit të parë dhe përse palët kontraktore lidhën kontratë me këtë kusht, ndërkohë që logjikisht, apartamenti ishte gati për banim.
26. Subjekti nuk shpjegoi asnjëherë përse motra e z. P. shlyeu një detyrim të këtij të fundit, në favor dhe pranë biznesit ku ai [z. P.] ishte bashkëpronar, për një pasuri për të cilën kishte kontratë sipërmarrjeje z. P.. Mbeti e pasqaruar dhe në mospërputhje me logjikën përse, nëse pranohej skenari i pretenduar nga subjekti që kjo pagesë ishte kryer që në vitin 2007, z. P. dhe znj. K. [personi i lidhur me subjektin] hynë në një kontratë të re – sipas tij në vitin 2016 – për të njëjtën pasuri, duke parashikuar këste të tjera pagese, pa asnjë referencë te pagesa prej mbi 50% të vlerës, shlyer tri (3) vite më herët nga motra e z. P. në favor apo për llogari të tij. Këto mangësi në arsyetim dhe shpjegime qëndrojnë edhe në vendimin e Komisionit, ndonëse zhvendosen te mungesa e logjikës për kontratën e vitit 2010. Këto rrethana faktike, si dhe të tjera që lidhen me kohën kur u ble apartamenti – në dhjetor 2016 – disa javë pasi vajza e subjektit të rivlerësimit u shkëput nga trangu familjar [megjithëse nga aktet rezulton që znj. K. dhe z. P. kishin një lidhje të konsoliduar në kohë dhe kishin edhe një fëmijë], dhe pak javë përpara plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting* nga subjekti, duket se nuk kanë gjetur peshë në analizën e Komisionit.
27. Në kushtet kur hetimi i Komisionit lidhur me këtë pasuri është orientuar në mënyrë të pabazuar drejt pagesës së pretenduar të kryer në vitin 2007, ndërsa aktet në fashikull provojnë se pasuria është krijuar më vonë, Kolegji në ankim e ka të pamundur të kryejë një vlerësim rrënjësor dhe të saktë të zbatimit të ligjit në rrethanat konkrete faktike dhe pamundëson kontrollin e mirëfilltë të kriterit pasuror të subjektit të rivlerësimit. Për sa më sipër, vlerësojmë që subjektit duhet t'i kishte kaluar barra e provës për fshehje të pasurisë. Në shpjegimet e tij kontradiktore, ai nuk arriti të

provojë saktësisht kohën kur janë kryer pagesat dhe as mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme nga bashkëjetuesi i vajzës së tij.

28. Në këtë argumentim kemi parasysh që në hetimin administrativ për këtë subjekt, Komisioni ka anashkaluar edhe problematika të tjera të pasurisë, të cilat parë në tërësi me sa kemi shtjelluar, krijojnë pamundësi për të ruajtur një standard të pritshëm dhe të parashikueshëm për rivlerësimin nga subjektet dhe publiku. Të tilla janë problemet e konstatuara në lidhje me kursimet e deklaruara jashtë sistemit bankar ndër vite nga subjekti, sikurse edhe mundësia e krijimit të tyre me burime të ligjshme, analizuar përkundër një serie kredish të marra nga personat e lidhur. Komisioni nuk duket të ketë pyetur subjektin për logjikën ekonomike të marrjes së kredive me barrën e interesave bankare që shoqërojnë ato në kushtet kur subjekti ka pretenduar kursime në *cash* të konsiderueshme jashtë sistemit bankar ndër vite. Nëse analiza financiare që ka kryer Komisioni merrte në konsideratë kursimet e deklaruara jashtë sistemit bankar nga subjekti, ky i fundit do të rezultonte me bilanc negativ të burimeve të ligjshme për vitin 2011, ndër të tjera⁴⁰.
29. Së fundmi, rezulton që pavarësisht se subjekti *nuk* ka provuar me dokumentacion udhëtimet që sipas tij ishin zyrtare, Komisioni ka pranuar pretendimet e tij deklarative, duke mos përllogaritur shpenzime udhëtimi, ashtu si edhe qëndrime të pretenduara të afërmit e tij. Në vlerësimin tërësor të kriterit pasuror, në përputhje me ligjin dhe jurisprudencën e Kolegjit, edhe këto aspekte, i kemi vlerësuar të kenë peshë në arsyetimin tonë.
30. Për gjithë sa më sipër, votuam për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit me nr. 188, datë 25.07.2019, pasi konkludam se subjekti i rivlerësimit Hysen Keta nuk arriti nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

⁴⁰ Ky konstatim fokusohet në vitet në të cilat subjekti ka krijuar pasuri sipas Komisionit. Nëse Komisioni do të kishte llogaritur kursimet e deklaruara prej subjektit ndër vite jashtë sistemit bankar, në përputhje me ligjin dhe jurisprudencën e Kolegjit që paradaton vendimin objekt shqyrtimi, konkretisht, ndër të tjera, vendimin nr. 11/2019, datë 22.05.2019, për subjektin e rivlerësimit E. I., vendimin nr. 14/2019, datë 09.07.2019, për subjektin e rivlerësimit, znj. A. B., ndër të tjerë, subjekti Hysen Keta do të rezultonte me mungesë burimesh për kursimet e deklaruara në vlerën prej 646.766 lekësh.